



Republika e Kosovës
Republika Kosova/Republic of Kosovo
Akademia e Drejtësisë/Akademija Pravde/Academy of Justice

Raporti Vjetor Financiar

Për vitin e përfunduar me 31 dhjetor 2024

Protokolli dalës i Organizatës Buxhetore

Protokolli hyrës i Thesarit të Kosovës

Permbajtja

DEKLARATË E PASQYRAVE FINANCIARE	- 4 -
Pasqyra e pranimeve dhe pagesave në para të gatshme	5
Raporti i ekzekutimit të buxhetit.....	6
Shënimi 2 deri 12 Prezantim i ndryshimeve materiale	7
Shënimet shpjeguese për pasqyrat financiare	7
Shënimi 1	7
1. Politikat kontabël	7
1.1 Informata për organizatën buxhetore (aktivitetet, legjislacioni, etj).....	7
Përmbushja e planit të punës dhe programeve trajnuese gjatë vitit 2024	8
Përmbledhje e të arriturve të AD në mbështetje të mekanizmave dhe proceseve euro integruese të institucioneve të drejtësisë	10
I. Përmbledhje e të arriturve nga Programi i Trajnimit Fillestar(PTF)	11
1. Aktivitetet e realizuara në kuadër të Programit të Trajnimit Fillestar (PTF) gjatë vitit 2024	11
1.1 Gjenerata X e gjyqtarëve të sapo emëruar (2023-2024)	11
1.2 Gjenerata XI e gjyqtarëve të sapo emëruar (2024-2025).....	12
1.3 Gjenerata XII e gjyqtarëve të sapo emëruar (2024-2025)	12
1.4 Gjenerata X e prokurorëve të sapo emëruar (2023-2024)	12
1.5 Trajnimi i trajnuesve	13
II. Përmbledhje e të arriturve nga Programi i Trajnimit të Vazhdueshëm (PTV).....	13
2. Aktivitetet trajnuese të realizuar gjatë vitit 2024 në kuadër të Programit për Trajnime të Vazhdueshme	14
2.1 Trajnimet për bashkëpunëtor profesional dhe zyrtar ligjor.....	16
2.2 Trajnimet për stafin administrativ gjyqësor dhe prokurorial	17
III. Programi për Hulumtime dhe Publikime (PHP).....	17
3.1 Aktivitetet në PHP	18
3.2 Zbatimi i procesit për vlerësim të nevojave trajnuese dhe hartimit të Programit Trajnues për vitin 2025;	18
3.3 Veprimtaria botuese dhe publikimi.....	19
3.4 Ofrimi i burimeve ligjore vendore dhe qasjes në burime ligjore nga rrafshi ndërkombëtarë.....	21
3.5 Hartimi i raporteve në baza periodike në zbatim të masave dhe politikave euro integruese.....	22
3.6 Analiza dhe mbledhja e të dhënave për vlerësimin e performancës së trajnuesve në zbatimin e trajnimeve fillestare dhe të vazhdueshme gjatë vitit 2024.....	22
IV. Aktivitetet në Departamenti Ligjore dhe shërbime të përgjithshme dhe Divizionet të tjerat	23
4.1 Njësia për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore	24
4.2 Teknologjia Informative	25
4.3 Prokurimi:	26

Buxheti dhe Financat:	27
Shpalosja e ndarjeve fillestare dhe finale të buxhetit.....	29
Shënimi 3 Mallra dhe shërbime	32
Shënimi 4 Shpenzime komunale	33
Shënimi 6 Shpenzime kapitale.....	34
Shënimi 11 Grantet e përcaktuara të donatorëve	35
Shënimi 12 Tjera.....	37
Shënimi 13 Pagesa nga palët e treta.....	37
Neni 17 Raport për detyrimet (faturat) e papaguara	38
Neni 19 Raport për pasurinë jo financiare	38
Neni 24 Raport për fondet e donatorëve të pashpenzuara	40
Neni 25 Raport për numrin e punëtorëve sipas listës së pagave.....	41
Neni 26 Raport për numrin e të punësuarve jashtë listës së pagave	41
Neni 27 Raport për numrin e të punësuarve me kontrate për shërbime te veçanta	41
Neni 28 Raport për gjendjen/zbatimin e rekomandimeve të Zyrës Kombëtare të Auditimit (ZKA)	42
Aneksi Nr. Kompensimi sipas ligjit për mbështetjen e punëve publike	42

Neni 12

DEKLARATË E PASQYRAVE FINANCIARE

Për: **NYSRET KOCA, U.D. Drejtor i Përgjithshëm i Thesarit**

Nga: **Enver Fejzullahu, Zyrtar Kryesor Administrativ (ZKA)**

Faton Fetoshi, Zyrtar Kryesor Financiar (ZKF)

Sipas mendimit tonë, pasqyrat financiare të cilat janë të bashkangjitura, përfshirë shënimet për vitin e përfunduar me 31 dhjetor 2024 janë përgatitur sipas Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit të Sektorit Publik të vitit 2017 "Raportimi Financiar sipas Kontabilitetit të bazuar në para të gatshme", i përmbushin të gjitha obligimet raportuese që dalin nga Ligji Nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë, të plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin nr. 03/L-221, Ligjin nr. 04/L-116, Ligjin nr. 04/L-194, Ligjin nr. 05/L-063 dhe Ligjin nr. 05/L-007 dhe janë të bazuara në shënimet financiare të mbajtura në mënyrë të duhur.

Kjo deklaratë jepet në lidhje me prezantimin e Pasqyrave Financiare të organizatës buxhetore për vitin që përfundon më 31 dhjetor 2024 dhe është pjese përbërëse e pasqyrave financiare.

Ne besojmë dhe konfirmojmë, që:

- Nuk ka pasur parregullsi lidhur me udhëheqësin apo me punëtorët, e cila ka mundur të ketë efekt material në pasqyrat financiare.
- Informatat e dhëna dhe të prezantuara në pasqyrat financiare lidhur me burimin e fondeve dhe shpenzimin e tyre të lidhura me Buxhetin e konsoliduar të Kosovës janë të plota dhe të sakta.
- Informatat në lidhje me grumbullimin e të hyrave janë të sakta.
- Nuk ka tjera llogari bankare të Buxhetit të Republikës së Kosovës përveç llogarive bankare të specifikuara në pasqyrat financiare dhe ky specifikim është i plotë dhe i saktë si në datën 31 dhjetor 2023.
- Nuk ka pasur shkelje të kërkesave të autoriteteve rregullatore të cilat kanë mundur të kenë efekt material në pasqyrat financiare.
- Nuk ka ndonjë ankesë (ligjore) në proces e cila mund të ketë efekt material në pasqyrat financiare
- Të gjitha detyrimet, si ato aktuale ashtu edhe kontingjente, dhe të gjitha garancitë që u kemi dhënë palëve të treta janë regjistruar dhe/ose janë shpalosur në mënyrën e duhur.
- Të gjitha huat e pranuar janë regjistruar dhe/ose janë shpalosur, sipas legjislacionit në fuqi
- Nuk ka pasur asnjë transaksion pas përfundimit të periudhës i cili do të kërkonte korrigjim ose shpalosje në pasqyrat financiare apo në shënimet e tyre.

Sipas mendimit tonë, pasqyrat financiare që janë të bashkangjitura paraqesin një prezantim të vërtetë dhe të paanshëm të financave dhe transaksioneve financiare për vitin e përfunduar me 31 dhjetor 2024 të Akademisë së Drejtësisë.

Data: __/__/____

Datë: __/__/____

Neni 13

Pasqyra e pranimeve dhe pagesave në para të gatshme

Pasqyra e pranimeve dhe pagesave të parave të gatshme për Akademinë e Drejtësisë

Për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2024

		2024	2023	2022
		Llogaria e vetme e Thesarit	Llogaria e vetme e Thesarit	Llogaria e vetme e Thesarit
		BKK	BKK	BKK
	Shënim	'000	'000	'000
BURIMET E FONDEVE -PRANIMET				
	Granti qeveritar	663	733	584
	Të hyrat vetanake			
	Të hyrat e dedikuara			
	Grantet e përcaktuara të donatorëve	4	17	25
	Financimet nga huamarrja			
	Klauzola e investimeve			
	Fondi zhvillimor në mirëbesim			
	Pranimet tjera			
Gjithsej		667	750	608
SHFRYTEZIMI I FONDEVE - PAGESAT				
	Operacionet			
	Paga dhe shtesa	2	229	213
	Mallra dhe shërbime	3	416	388
	Shpenzime komunale	4	9	8
		619	654	608
	Transferet			
	Transfere dhe subvencione	5	-	
	Shpenzime kapitale			
	Prona, ndërtesa dhe pajisje	6	96	
	Pagesa tjera	7		
Gjithsej		667	750	608

Shënim: Pagesat nga palët e treta prezantohen në shënimin 13 në përputhje me SNKPS 2017, efektive nga 1 janari 2019

Neni 14

Raporti i ekzekutimit te buxhetit

Pasqyra e krahasimit të shumave buxhetore dhe aktuale për Akademinë e Drejtësisë

Për vitin e përfunduar me 31 dhjetor 2024

		2024				2023	2022
		Realizimi	Buxheti final	Buxheti fillestar	Ndryshimi	Realizimi	Realizimi
		A	B	C	D=B-A	E	F
		€ '000	€ '000	€ '000	€ '000	€ '000	€ '000
Shënime							
HYRJA E PARASË SË GATSHME							
Të hyrat tatimore	8				-		
Të hyrat jo tatimore	9				-		
Të hyrat e dedikuara	10				-		
Grantet e përcaktuara të donatorëve	11	4	4		-	17	27
Tjera	12				-		
Gjithsej Pranimet		4	4	-	-	17	27
DALJA E PARASË SË GATSHME							
Paga dhe shtesa	2	254	255	277	0	229	213
Mallra dhe shërbime	3	354	424	520	70	416	388
Shpenzime komunale	4	11	11	17	0	9	8
Transfere dhe subvencione	5	-	-		-		
Shpenzime kapitale	6	49	50	50	1	96	
Rezerva		-	-		-		
Tjerat	7	-	-		-		
Gjithsej pagesat		667	740	863	72	750	608

Shënimi 2 deri 12 Prezantim i ndryshimeve materiale

Për dallim prej shënimeve 2 deri 12, këto shënime përdoren për të sqaruar dallimin **material** në kolonën **D** (neni 14), domethënë dallimin material të realizimit të buxhetit. SNKSP në bazë të parasë se gatshme kërkon të sqarohen dallimet materiale. Varësisht nga madhësia e dallimit, nuk kanë nevojë të ofrohen shpjegime për të gjitha kategoritë, andaj mund të kërkojnë ndryshime në sistemin e numërimit të shënimeve. Kur të sqarohen dallimet e ndonjë kategorie të ndarjes, duhet të jepet përmbledhja e natyrës ndryshimit.

Neni 15

Shënimet shpjeguese për pasqyrat financiare

Shënimi 1

1. Politikat kontabël

Pasqyrat Financiare për vitin e përfunduar me 31 dhjetor 2024 janë përgatitur sipas Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit të Sektorit Publik të vitit 2017 “Raportimi Financiar sipas Kontabilitetit të bazuar në para të gatshme”, i përmbushin të gjitha obligimet raportuese që dalin nga Ligji Nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë, të plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin nr. 03/L-221, Ligjin nr. 04/L-116, Ligjin nr. 04/L-194, Ligjin nr. 05/L-063, Ligjin nr. 05/L-007 dhe Ligjin 08/L-183 Për mbështetjen e punëve publike.

1.1 Informata për organizatën buxhetore (aktivitetet, legjislacioni, etj)

Akademia e Drejtësisë ka përgatitur Pasqyrat Financiare në harmoni me kërkesat e Ligji Nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë, të plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin nr. 03/L-221, Ligjin nr. 04/L-116, Ligjin nr. 04/L-194, Ligjin nr. 05/L-063 dhe Ligjin nr. 05/L-007.

Sipas LMFPF të gjitha transaksionet me fonde brenda Fondit të Konsoliduar të Republikës së Kosovës behen përmes Llogarisë së Vetme të Thesarit.

Me Ligjin Nr. 05/L-095 për Akademinë e Drejtësisë (AD), Akademia e Drejtësisë është institucion publik, i pavarur cili është në funksion të ngritjes së kapaciteteve profesionale dhe interdisciplinare të gjyqtarëve, prokurorëve, stafit administrativ gjyqësor dhe prokurorial si dhe sipas kërkesave dhe mundësive edhe për profesionet e lira. Akademia e Drejtësisë këtë funksion e realizon përmes zhvillimit dhe zbatimit të programeve trajnuese dhe burimeve ligjore në përputhje me nevojat adekuate për

trajnime të cilat identifikohen nga procesi i vlerësimit të nevojave trajnuese. Akademia e Drejtësisë kryen edhe analiza, hulumtime si dhe kryen veprimtari botuese për nevojat e sistemit gjyqësor dhe prokurorial si dhe profesioneve tjera të ligjore.

Organet kryesore të AD-së janë: Këshilli Drejtues, Këshilli Programor dhe Drejtori Ekzekutiv, ku përgjegjësitë e të cilëve janë të përcaktuar me Ligjin për Akademinë e Drejtësisë.

Në kuadër të strukturës së brendshme organizative të AD-së, përveç Këshillit Drejtues si organ udhëheqës dhe Këshillit Programor si organ profesional dhe këshillëdhënës, përfshihet edhe Zyra e Drejtorit të AD-së, Departamenti i Programeve dhe Departamenti për Administratë dhe Financa.

Aktualisht AD, realizon funksionet ligjore në bazë të tri programeve kryesore të cilat operojnë në kuadër të Departamentit të Programit: Programi për Trajnime të Vazhdueshme, Programi për Trajnime Fillestare dhe Programi për Hulumtime dhe Publikime.

Në kuadër të këtyre programeve trajnuese përfshihen të gjitha aktivitetet të cilat janë të përcaktuara me ligj dhe aktet tjera normative, e të cilat paraqesin mandatin e Akademisë.

- **Misioni**

Akademia ofron trajnim cilësor gjyqësor për gjyqtarë, prokurorë dhe staf administrativ gjyqësor dhe prokurorial, si dhe për profesionistë të tjerë në gjyqësor, analiza, hulumtime dhe veprimtari botuese, në përputhje me kornizën ligjore dhe standardet më të mira të njohura ndërkombëtare.

- **Vizioni**

Akademia është institucion modern i të mësuarit, i përshtatur ndaj dinamikës së përgjithshme të zhvillimit, kontribuues kryesor për një gjyqësor të paanshëm, të pavarur dhe profesional që gëzon besimin e publikut.

Përmbushja e planit të punës dhe programeve trajnuese gjatë vitit 2024

Bazuar në mandatin e saj ligjor, Akademia e Drejtësisë është e angazhuar në aftësimin dhe përgatitjen e gjyqtarëve dhe prokurorëve të rinj për sistem si dhe në rritjen e kapaciteteve profesionale të gjyqtarëve, prokurorëve, bashkëpunëtorëve profesional dhe profesionistëve të tjerë ligjor. Në funksion të kësaj gjatë vitit 2024, AD ka zbatuar gjitha aktivitetet sipas programeve trajnuese fillestare dhe të vazhdueshme dhe objektivave të përcaktuara në këto programe dhe Planin e Punës dhe Performancës për vitin 2024.

Për realizimin e Planit të punës dhe Performancës së AD-së për vitin 2024 ka përgatitur planin e veprimit duke përcaktuar aktivitetet, njësitë përgjegjëse, afatet kohore dhe rezultatet që duhen arritur për zbatimin e të gjitha aktiviteteve të planifikuara.

Në kuadrin e trajnimeve fillestare është vazhduar zbatimi i trajnimit fillestar për 29 gjyqtarët dhe 23 prokurorët e sapo emëruar, gjenerata e X të cilët trajnimin e kanë filluar në muajin prill të viti 2023. Grupi i gjyqtarëve ka përfunduar sesionet e trajnimit teorik në muajin nëntor 2023 meqë kanë realizuar sesionet e trajnimit teorik intenzivisht në 5 ditë të javës dhe nga ky muaj kanë vazhduar sesionet e trajnimit praktik deri në muajin prill 2024 në gjykatat përkatëse nën mbikëqyrjen e mentorit. Në kuadër të këtij trajnimit praktik, gjyqtarët nën mbikëqyrjen e gjyqtarit mentorë kanë shqyrtuar lëndët dhe kanë asistuar në të gjitha aktivitetet gjyqësore që kanë qenë sipas planit të punës. Grupi i prokurorëve kanë vijuar sesionet e trajnimit teorik në çdo javë, 2 ditë trajnimi teorik në AD dhe 3 ditë tjera trajnimin praktik në prokurori dhe kanë përfunduar në muajin prill 2024.

Përveç kësaj gjenerate, nga muaji shkurt i vitit 2024 ka filluar trajnimi fillestar edhe për gjeneratën e XI të gjyqtarëve të gjyqtarëve (15 gjyqtarë). Gjyqtarët kanë vijuar sesionet e trajnimit teorik në 5 ditë të javës në AD për 6 muaj me radhë. Më pas me sesionet e trajnimit praktik në gjykatat përkatëse. Ndërkaq në fillim të muajit shtator ka filluar trajnimin edhe gjenerata e XII e gjyqtarëve të sapo emëruar të cilët në periudhën raportuese janë duke ndjekur trajnimin teorik në Akademi të Drejtësisë komfor programit trajnues.

Në kuadër të trajnimeve të vazhdueshme për gjyqtarë dhe prokurorë të shtetit janë realizuar 177 aktivitete trajnuese, me gjithsej 243 ditë trajnimi. Nga 177 aktivitetet trajnuese 117 apo XX % janë mbështete nga donatorët, ndërsa 60 apo XX% janë realizuar nga buxheti i Akademisë së Drejtësisë. Prandaj programi i trajnimeve të vazhdueshme është përmbushur në tërësi dhe për më tepër siq shihet është tejkaluar planifikimi meqë ka pasur edhe trajnime shtesë si rezultat i kërkesave dhe projekteve me donatorë. Këto aktivitete përfshijnë risitë ligjore në fushën administrative, luftimin e krimeve të rënda dhe të organizuara, korrupsionin e nivelit të lartë, trajnim për konfiskim të aseteve virtuale, trajnime për mbrojtjen e të dhënave personale, trajnime për konventën e Stambollit, trajnim për treguesit gjeografik dhe emërtimet e origjinës, trajnim për armët e zjarrit, drogë dhe krimin e organizuar, trajnime kundër diskriminimit etj

Pjesë e rëndësishme e aktiviteteve të AD-së ishte ngritja e cilësisë së metodologjisë trajnuese dhe fuqizimi edhe më tej i Doracakut për trajnues përmes trajnimit të trajnuesve si dhe vlerësimit të performancës së trajnuesve të angazhuar gjatë këtij viti.

E veçantë e këtij viti ishin edhe trajnimet bazike për 15 gjyqtarët porotë dhe përgatitja tyre për ushtrimin e funksionit të gjyqtarit porotë. Këta gjyqtarë janë emëruar në këtë pozitë gjatë vitit 2023 por nuk kanë arritur të jenë pjesë e trajnimit me grupin e parë 87 gjithsejtë që vijuan trajnimin në Akademi të Drejtësisë menjëherë pas emërimit.

Krahas trajnimeve për gjyqtarë dhe prokurorë janë realizuar edhe aktivitete trajnuese për bashkëpunëtorët profesional dhe zyrtarët ligjor të gjykatave dhe prokurorive dhe zyrtarët e ndihmës juridike falas si dhe stafin administrativ gjyqësor dhe prokurorial. Këto aktivitete trajnuese kishin si qëllim përfshirjen sa më shumë të këtyre kategorive në trajnimet bazike nga moduli-aspekti penal material dhe procedural dhe aspekti civil material dhe procedural si dhe trajnime për drejtësinë për të mitur dhe trajnime tjera.

Gjatë vitit 2024 janë realizuar edhe aktivitetet trajnuese për profesionistët tjerë ligjor, veçanërisht për ndërmjetësuesit. Avokatë Shtetëror, Mbrojtësit e viktimave, Policia e Kosovës, Shërbimi Sprovues dhe korrektues, zyrtarë nga MKRS dhe MTI, profesionistë tjerë ligjor, bashkëpunëtorët profesional dhe zyrtarë ligjorë kanë përfituar nga trajnimet e vazhdueshme të përbashkëta me gjyqtarë dhe prokurorë të shtetit.

Në kuadrin e vlerësimit të nevojave trajnuese për gjyqtarë dhe prokurorë është zhvilluar procesi konform planifikimit. Janë përfshirë gjithë akteret e sistemit gjyqësor dhe prokurorial duke i shteruar gjitha burimet e informacionit përfshirë edhe rekomandimet që dalin nga dokumentet strategjike të vendit dhe me punëtoritë e përbashkëta janë përcaktuar prioritetet në programet trajnuese. Në përfundim të këtij procesi është hartuar raporti i cili ofron analizën e vlerësimit të nevojave trajnuese për vitin 2025, ecurinë e procesit, metodologjinë si dhe rezultatet dhe të gjeturat nga ky proces. Në fushën e botimeve janë realizuar dy botime me Gjykatën Supreme: Vendimet e përzgjedhura dhe Përmbledhja nga praktika e Gjykatës Supreme të Kosovës në çështje civile dhe penale të cilat tashmë janë të përkthyera edhe për versionin në serbisht dhe të publikuara në faqen e AD-së dhe Gjykatës Supreme. Në periudhën raportuese është iniciuar edhe botimi i një udhëzuesi për provat elektronike nga disa gjyqtarë. Ky dokument është në proces të hartimit meqë janë identifikuar çështjet ligjore që do të trajtohen në kuadër të këtij botimi dhe autorët përkatës ndërkaq, finalizimi i tij pritet më së largu në katër mujorin e parë të viti 2025. Aktivitetet në Departamentin për Shërbime Ligjore dhe të Përgjithshme, brenda përgjegjësi dhe me kompetence ka vazhduar në ofrimin e shërbimeve dhe mbështetjes për Këshillin Drejtues, Këshillin Programor, Departamentin e Programeve si dhe divizioneve të tjera të AD. Gjatë vitit 2024 sipas planit të punës, aktivitete të departamentit janë fokusuar në vazhdimin e përmbushjes së reformës së administratës publike, reformës legjislative sipas pakos së ligjeve për drejtësinë duke përfshirë edhe plotësimin ndryshimet e ligjit të AD. Ndërsa në Divizionin për buxhet dhe financa është ekzekutuar buxheti konform ligjit për ndarje buxhetore dhe kornizën ligjore për menaxhimin e financave publike. Gjatë vitit 2024 është përgatitur kërkesa buxhetore për vitet 2025-2027, janë realizuar të gjitha pagesat me kohë për obligimet që kanë dale nga aktivitetet e AD sipas planit të punës dhe performancës, ndërsa plani i prokurimit është realizuar në tersi.

Përmbledhje e të arriturave të AD në mbështetje të mekanizmave dhe proceseve euro integruese të institucioneve të drejtësisë

Edhe në periudhën raportuese Akademia e Drejtësisë ka vazhduar përkushtimin e saj në zbatimin e masave dhe kërkesave nga dokumentet strategjike në nivel nacional dhe në përgatitjen e raporteve në baza periodike për Strategjinë për sundimin e Ligjit, Strategjinë për mbrojtjen nga dhuna në familje, Programin Kombëtar për të Drejtat e njeriut dhe dokumente tjera strategjike në nivel nacional të cilat janë si rrjedhojë e MSA-së dhe raportit të BE-së për Kosovën. Janë realizuar një mori e aktiviteteve trajnuese që janë rezultat i kërkesave nga këto dokumente si në fushën e të drejtave të njeriut, për dhunën në familje, drejtësinë komerciale, drejtësinë për fëmijë, për aspektin e të drejtave të njeriut si dhe për krimin e organizuar dhe korrupsionin.

Në vazhdimësi janë hartuar raportet në baza të rregullta për institucionet dhe mekanizmat përkatës. Nga raportet e ndryshme veçanërisht të strategjive të lartpërmendura, Akademinë e Drejtësisë për kundër kapaciteteve të limituara qoftë njerëzore ashtu edhe financiare e vendosin në institucionet më të përgjigjshme si në zbatim ashtu edhe në raportimin e masave.

Përveç mekanizmave integruar në BE, Akademia e Drejtësisë në vazhdimësi ka bashkëpunuar me KGJK dhe KPK dhe njësitë për shqyrtimin e performancës së gjyqtarëve dhe prokurorëve që veprojnë në kuadër të dy këshillave duke i ofruar të dhëna mbi vijueshmërinë e gjyqtarëve dhe prokurorëve në trajnime.

I. Përmbledhje e te arriturave nga Programi i Trajnimit Fillestar¹(PTF)

Akademia e Drejtësisë është përgjegjëse për organizimin e trajnimit fillestar për aftësimin e gjyqtarëve dhe prokurorëve të sapo emëruar.

Programi i trajnimit fillestar (më tutje PTF) zgjatë 12 muaj dhe organizohet sipas kësaj strukture: model i kombinuar i teorisë dhe praktikës ku përfshihen të gjitha degët e së drejtës dhe ligjeve vendore, Acquis Communautaire, Konventa Evropiane për të Drejta e Njeriut dhe akte të tjera ndërkombëtare po ashtu përfshinë edhe trajnime me karakter interdisiplinar dhe shqyrtimin e rasteve nga praktika gjyqësore, zhvillimi i shkathtësive në përfaqësim, simulime etj.

Ndërsa pjesa e dytë, trajnimi praktikë zhvillohet në gjykata/prokurori ku ata janë emëruar dhe përfshinë aspektet praktike të punës së gjyqtarit/prokurorit ku fokusohet në zhvillimin e shkathtësive praktike me qëllim të aplikimit të tyre pas përfundimit të trajnimit.

Programi trajnues është miratuara nga Këshilli Drejtues i Akademisë së Drejtësisë, sipas këtij programi, trajnimi teorik është i ndarë në sesione dhe realizohet përmes gjashtë (6) moduleve trajnues bazë për gjyqtar dhe pesë (5) module për prokuror. Trajnimi praktik realizohet në gjykata dhe prokurori ku ata janë emëruar nën mbikëqyrje e mentorit, ndërsa AD monitoron këtë proces. Gjithashtu pjesë përbërëse e programit trajnues janë edhe vizitat/trajnimet në institucione jo gjyqësore të cilat kanë për qëllim të ju ofrojnë njohuri gjyqtarëve/prokurove të shtetit të sapo emëruar me legjislacionin dhe praktikën që zbatojnë institucionet shtetërore gjatë punës së tyre, si dhe aktivitete që kryejnë këto institucione, të ndërlidhura me punën e gjyqtarit dhe prokurorit.

1. Aktivitetet e realizuara në kuadër të Programit të Trajnimit Fillestar (PTF) gjatë vitit 2024

Gjatë vitit 2024, trajnimin fillestar kanë ndjekur 98 pjesëmarrës prej tyre 75 gjyqtarë të sapo emëruar dhe 23 prokuror të sapo emëruar si në vijim:

- Gjenerata X e gjyqtarëve të sapo emëruar (29),
- Gjenerata XI e gjyqtarëve të sapo emëruar (15),
- Gjeneratat XII e gjyqtarëve të sapo emëruar (31);
- Gjenerata X e prokurorëve të sapo emëruar (23),

Të gjitha gjeneratat e lartcekura kanë përmbyshur objektivat e përcaktuar në Planin e Punës dhe Programin Trajnues gjithashtu të gjitha aktivitetet e parapara janë realizuar komform kalendarit trajnues.

1.1 Gjenerata X e gjyqtarëve të sapo emëruar (2023-2024)

Gjenerata X e gjyqtarëve të sapo emëruar, ka filluar me 24 prill 2023, trajnimin fillestar dhe ka përfunduar me 24 maj 2024. Programi trajnues është realizuar në mënyrë të ndarë ku fillimisht është realizuar trajnimi teorik për 6 muaj dhe ka vazhduar me trajnimin praktik në gjykata ku janë emëruar. Sipas programit trajnues fillestar për gjyqtarët e gjeneratës së X gjatë vitit 2024, janë realizuar në kuadër të trajnimit praktik në total **99** ditë trajnim praktik. Trajnimin fillestar e kanë ndjekur 29 gjyqtar të sapo emëruar, një nga komunitetit boshnjak dhe një nga ai turk.

¹ Neni 19 Ligjit Nr. 05/L-095 për Akademinë e Drejtësisë

1.2 Gjenerata XI e gjyqtarëve të sapo emëruar (2024-2025)

Gjenerata e XI e gjyqtarëve të sapo emëruar, ka filluar trajnimin fillestar me 05 shkurt 2024 dhe pritet të përfundojë me 25 shkurt 2025. Sipas programit të trajnimit fillestar për gjyqtarët gjatë vitit 2024, në total janë realizuar gjithsejtë 213 aktivitete si në vijim: 117 ditë trajnimi teorik apo 234 sesione trajnuese, 96 ditë trajnim praktik prej tyre 5 vizita në institucione jo gjyqësore. Trajnimi teorik është zhvilluar në mënyrë të kombinuar me raste nga praktika gjyqësore, raste specifike të simuluar, dhe trajnimi praktik është duke u realizuar në gjykatat përkatëse ku janë emëruar nën mbikëqyrjen e mentorit. Trajnimin fillestar për këtë gjeneratë janë duke e ndjekur 15 gjyqtarë të sapo emëruar.

1.3 Gjenerata XII e gjyqtarëve të sapo emëruar (2024-2025)

Gjyqtarët e sapoemëruar të kësaj gjenerate trajnimin fillestar e kanë filluar me dt. 06 shtator 2024, dhe do të vazhdojë deri në fund të muajit shtator të vitit 2025. Trajnimi fillestar për gjyqtarët sipas programit trajnues realizohet 6 muaj trajnim teorik në Akademi të Drejtësisë dhe 6 muaj në gjykatat përkatëse ku janë të emëruar. Në periudhën raportuese në kuadër të trajnimit teorik janë realizuar 79 ditë trajnimi apo 158 sesione trajnuese, këtë gjeneratë janë duke e ndjekur 31 gjyqtarë të sapo emëruar.

1.4 Gjenerata X e prokurorëve të sapo emëruar (2023-2024)

Prokurorët e sapoemëruar të kësaj gjenerate trajnimin fillestar e kanë filluar me dt. 24 prill 2023 dhe kanë përfunduar me dt. 25 maj të vitit 2024. Trajnimi fillestar për prokuror sipas programit trajnues realizohet sipas modelit të kombinuar dy ditë trajnim teorik në Akademi dhe tri ditë trajnim praktik në prokurorit përkatëse ku janë emëruar.

Në periudhën raportuese në total janë realizuar: 112 ditë prej tyre janë realizuar 26 ditë trajnimi teorik apo 52 sesione trajnuese, 66 ditë trajnim praktik prej tyre 8 vizita në institucionet jo gjyqësore në prokurorit përkatëse ku janë emëruar. Trajnimi fillestar është zbatuar konform programit trajnues dhe metodologjinë të përcaktuar dhe këtë gjeneratë e kanë ndjekur 23 prokuror të sapo emëruar. Në këtë gjeneratë janë emëruar 23 prokuror por nga muaji dhjetor 2023 trajnimin e kanë ndjekur 24 prokuror duke përfshirë edhe një prokurore e cila me kërkesën/rekomandimin e KPK-së dhe aprovimin nga Këshilli Drejtues i Akademisë ka vazhduar trajnimin me këtë gjeneratë pasi e njëjta ka ndërprerë ndjekjen e trajnimit me gjeneratën IX për shkak të pushimit të lehonisë. Sipas këtij vendimi së bashku me gjeneratën e X të prokurorëve, ka vazhduar trajnimin fillestar prej dt. 04 dhjetor 2023, deri me dt. 17 maj 2024, me gjeneratën e X në modulet e përbashkëta e gjithashtu ka realizuar edhe të disa moduleve trajnuese në mënyrë individuale prej tyre 6 ditë trajnimi teorik apo 12 sesione, 80 ditë trajnim praktik në prokurori dhe 8 vizita në institucione jo gjyqësore dhe ka përmbushur në tërësi programin e trajnimit fillestar komform vendimit.

Gjyqtarë / prokurorë të sapoemëruar	Nr. i të trajnuarve	Gjinia		Totali i ditëve të trajnimit	Ditë trajnimi teorik	Ditë trajnimi praktik	Sesione Trajnuese	Orë Trajnimi	Trajnues të angazhuar	Mentor të angazhuar
		M	F							
Gjenerata X e gjyqtarëve	29	17	12	99	/	99	/	/	/	29
Gjenerata XI e gjyqtarëve	15	9	6	213	117	96	234	702	36	29

Gjenerata XII e gjyqtarëve	31	17	14	79	79	/	158	474	26	/
Gjenerata X e prokurorëve	23 ^[3]	14	9	112	26	66	52	156	15	22
Totali	98	57	41	503	222	261	444	1332	77	80

Tabela përmbledhëse për trajnimin fillestar PTF për vitin 2024

1.5 Trajnimi i trajnuesve

Trajnimi i trajnuesve si proces që siguron trajnuesit të pajisen me njohuri, aftësi dhe teknika të avancuar në fushën e trajnimit dhe edukimit, Akademia gjatë vitit 2024, ka realizuar në total 5 trajnime të trajnuesve prej tyre një (1) në fushën e drejtësisë për fëmijë, një (1) në fushën e të drejtave të njeriut neni 10 i KEDNJ dhe tre (3) trajnime lidhur me metodologjinë trajnuese të Akademisë së Drejtësisë të bazuara në Doracakun për Trajnues.

Fusha e trajnimit/ tema e trajnimit	Nr. i trajnimeve	Ditë e trajnimit	Numri i të trajnuarve
Metodologjia e sipas Doracakut për trajnues të Akademisë së Drejtësisë	3	6	78
Neni 10 i KEDNJ	1	2	12
Standardet ndërkombëtare dhe evropiane për të drejtat e fëmijëve dhe drejtësinë për të mitur, teknikat e intervistimit, perspektiva gjinore dhe komunikimi miqësor me fëmijët gjatë proceseve gjyqësore	1	3	9
Totali	3	11	99

II. Përmbledhje e te arriturave nga Programi i Trajnimit të Vazhdueshëm (PTV)

Programi për Trajnime të Vazhdueshëm synon avancimin e vazhdueshëm të njohurive profesionale dhe interdisiplinare të gjyqtarëve, prokurorëve, stafit administrativ gjyqësor dhe prokurorial si dhe profesionistëve të tjerë ligjor. Struktura e Programit për Trajnimeve të Vazhdueshme përmban tema të karakterit kryesisht profesional duke i përfshirë edhe temat të karakterit interdisiplinar.

Programi është gjithëpërfshirës dhe trajton tema dhe problematika nga fusha: penale, civile, drejtësia për fëmijë - aspekti civil dhe penal, drejtësia komerciale, administrative, E Drejta Kushtetuese, trajnimet për Konventën Evropiane për të Drejtat e Njeriut – KEDNJ, trajnimet nga E Drejta e BE-së, kundërvajtje, ndërmjetësim, trajnimet për mos diskriminim, trajnimet për dhunën ndaj grave, dhunën në familje dhe dhunën në baza gjinore, si dhe trajnimet nga kompetenca interdisciplinare.

Në kuadër të PTV-së organizohen aktivitetet trajnuese për gjyqtarë, prokurorë, gjyqtar porotë, bashkëpunëtorë profesional, zyrtar ligjor si dhe stafin administrativ gjyqësor dhe prokurorial.

^[3] Nga muaji dhjetor 2023, gjeneratës së dhjetë të prokurorëve kësaj gjenerate i është bashkuar prokuroria nga gjenerata e IX e cila ka përfunduar pushimin e lehonisë.

Akademia e Drejtësisë me kërkesë të institucioneve kompetente dhe sipas mundësisë organizon trajnime edhe për avokatë shtetëror, avokatë, noter, përmbarues privat, ndërmjetësues dhe administratorë falimentues. Metodologjia e realizimi të aktiviteteve trajnuese ishte e kombinuar duke përfshirë trajnime, tryeza dhe punëtori.

2. Aktivitetet trajnuese të realizuar gjatë vitit 2024 në kuadër të Programit për Trajnime të Vazhdueshme

Në kuadër të PTV-së gjatë periudhës raportuese, janë realizuar **177** aktivitete trajnuese, me gjithsej **243** ditë trajnimi.

Numri i përgjithshëm i pjesëmarrësve ishte **3867**;

- **969** gjyqtarë,
- **297** prokurorë,
- **296** ndërmjetësues
- **1532** bashkëpunëtor profesional dhe zyrtar ligjor (Bashkëpunëtor profesional 779 dhe Zyrtar Ligjor 730, 23 zyrtare te ANJF)
- **773** të tjerë.

Nga **177** aktivitete trajnuese të realizuara gjatë vitit 2024:

- **90** ishin për gjyqtarë, prokurorë dhe kategori tjera përfituese;
- **12** trajnime për profesione te lira (ndërmjetësues);
- **60** trajnime për Bashkëpunëtor profesional dhe Zyrtar Ligjor (53 trajnime nga Moduli Bazik dhe 7 trajnime tjera për Bashkëpunëtor Profesional/Zyrtar Ligjor);
- **1** për Menaxhmentin e prokurorisë;
- **14** trajnime për Stafin Administrativ gjyqësor dhe prokurorial.

Në mbështetje të partnerëve ndërkombëtarë janë realizuar një numër i konsiderueshëm i aktivitete trajnuese duke kombinuar kështu ekspertize vendore me atë ndërkombëtare. Nga **177** aktivitet trajnues **117** janë mbështete nga donatorët, ndërsa **60** janë realizuar nga buxheti i Akademisë së Drejtësisë.

Nga **90** trajnime të realizuara për gjyqtarë dhe prokurorë, **74** janë realizuar me mbështetjen e donatorëve dhe **16** nga buxheti i Akademisë së Drejtësisë (për detaje shih tabelën nr. 2).

Tabela nr. 1 Përmbledhje e aktiviteteve trajnuese te vazhdueshme 2024

Programi për Trajnime të Vazhdueshme Aktivitetet trajnuese të realizuar gjatë vitit 2024						
Nr.	Përfituesit	Trajnime Tryeza	Ditë trajnimi	Pjesëmarrës	Tipi i Pjesëmarrjes	
1.	Aktivitete Trajnuese të realizuar gjatë 2024	177	243	3877 (një pjesëmarrësi i trajnuar më shumë se njëherë)	Gjyqtarë, Prokurorë dhe tjerë	
2.	Gjyqtarë dhe prokurorë	90	135	3008	Gjyqtarë	969
					Prokurorë	297
					Bashkëpunëtorë Profesional	
					Zyrtar Ligjor	
					Te tjerë	1079
3.	Trajnime për profesione te lira (ndërmjetësues	12	24	296		
4.	Bashkëpunëtor profesional dhe Zyrtar Ligjor – Moduli Bazik (civile dhe penale)	53	53	1426	Bashkëpunëtor Profesional	715
					Zyrtar Ligjor	688
					Zyrtare te ANJF	23
5.	Trajnime tjera për Bashkëpunëtor profesional dhe Zyrtar Ligjor	7	14	106	Bashkëpunëtor Profesional	64
					Zyrtar Ligjor	42
6.	Trajnime Menaxhimi i prokurorisë	1	1	20		
7.	Stafi Administrativ gjyqësor dhe prokurorial	14	16	263		

Tabela nr. 2 Aktivitetet trajnuese te vazhdueshme te realizuara nga AD dhe Donatoret

177 Aktivitetet Trajnuese të realizuara gjatë vitit 2024 në kuadër të PTV-së														
▪ 60 janë realizuar nga Buxheti i AD-se 117 nga Donatoret														
Aktivitete Trajnuese për Gjyqtarë dhe prokurorë			Bashkëpunëtor profesional			Stafi Administrativ gjyqësor dheprokurorial			Menaxhmentin e Prokurorisë		Profesione të Lira Ndërmjetësues			
90	AD	16	60	AD	33	14	AD	11	1	AD	0	12	AD	0
	Donator	74		Donator	27		Donator	3		Donator	1		Donator	12

Tabela nr. 3 Numri i Trajnimeve te vazhdueshme të realizuara ne mbështetje të Donatorëve 2024

Numri i Trajnimeve te vazhdueshme të realizuara ne mbështetje të Donatorëve 2024		
Nr.	Trajnimet e financuara	Totali
1.	US-DOJ/OPDAT	15
2.	USAID / Drejtësia Komercale	15
3.	Ambasada Franceze	2
4.	OSBE	4
5.	Këshilli i Evropës - Projekti Përafrimi i ligjeve dhe politikave me Konventën e Stambollit	4
6.	KE/Mbështetja e Gjykatës Kushtetuese në zbatimin dhe shpërndarjen e standardeve të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut	3
7.	Këshilli i Evropës - PECK III	1
8.	Këshilli i Evropës - PRO-FREX	1
9.	GIZ (Deutsche Gesellschaft für Internationale Zusammenarbeit)	18
10.	UNODC - Programi Global i Armëve të Zjarrit	2
11.	Terre des hommes	3
12.	UNDP/SAEK	2
13.	CLARD - Qendra për Ndihmë Juridike dhe Zhvillim Regjional	2
14.	Humanitarian Law Center Kosovo – Fondi për të Drejtën Humanitare	1
15.	IRZ (German Foundation for International Legal Cooperation)	1
16.	EULEX	12
17.	UNHCR	2
18.	Western Balkans Rule of Law Initiative (WBROLI)	9
19.	IPROCEEDS	1
20.	BIRN	1
21.	KOMF	1
22.	Fondacioni për të drejtat e kafshëve	1
23.	QKRMT	2
24.	FMCS – INL dhe IKD	12
25.	SIGMA	2
TOTALI		117

2.1 Trajnimet për bashkëpunëtor profesional dhe zyrtar ligjor

Roli i bashkëpunëtorëve profesional dhe zyrtarëve ligjor është i veçantë dhe ndikon në zhvillimin, avancimin dhe ngritjen e efikasitetit në sistemin gjyqësor, andaj, ngritja e kapaciteteve profesionale është një ndër prioritetet e Akademisë së Drejtësisë.

Gjatë vitit 2024 për bashkëpunëtor profesional dhe zyrtarë ligjore janë realizuar gjithsej 60 trajnime me kohëzgjatje 67 ditë trajnimi, me numër te pjesëmarrjes 1522 veta.

Nga Modulet e trajnimit bazik për bashkëpunëtorët profesional, në lëmin civile dhe penale janë gjithsej 53 trajnime me kohëzgjatje 53 ditë trajnimi. Nga lëmia penale, materiale dhe procedurale janë realizuar 35 trajnime, nga lëmia civile materiale dhe procedurale janë realizuar 18 trajnime. Numri i pjesëmarrjes ne modulin bazik 1426, prej tyre 715 bashkëpunëtor profesion, 688 zyrtar ligjor dhe 23 nga Agjencia për Ndihmë Juridike Falas.

Trajnime tjera për Bashkëpunëtor Profesionalë dhe Zyrtar Ligjor janë realizuar gjithsej 7 trajnime me kohëzgjatje 14 ditë trajnimi me numër të pjesëmarrjes 96 veta.

Numri i përgjithshëm i pjesëmarrësve ishte 1523. Numri i pjesëmarrjes në trajnimet nga Moduli bazik (penale dhe civile) ishte 1427, numri i pjesëmarrjes nga trajnimet tjera për bashkëpunëtor profesional dhe zyrtare ligjor ishte 96.

Tabela nr. 4 Trajnime të realizuara për Bashkëpunëtorë Profesional dhe Zyrtarë Ligjor

Moduli Bazik për Bashkëpunëtorë Profesional & Zyrtarë Ligjor	Nr.	Trajnimet e financuara	Nr.	Trajnime tjera për Bashkëpunëtorë Profesional & Zyrtarë Ligjor	Nr.	Trajnimet e financuara
Trajnime të realizuara	53	Akademia e Drejtësisë	33	Trajnime të realizuara	7	Trajnimet e financuara Western Balkans Rule of Law Initiative (WBROLI)
Penale	35	GIZ	10	Bashkëpunëtorë Profesional	64	
Civile	18	EULEX	10	Zyrtarë Ligjor	42	
Bashkëpunëtorë Profesional	715					
Zyrtarë Ligjor	688					
Zyrtar nga ANJF	23					
Total	1426		53		106	7

2.2 Trajnimet për stafin administrativ gjyqësor dhe prokurorial

Gjatë periudhës raportuese, Akademia e Drejtësisë, ka realizuar edhe 7 trajnime për stafin administrativ gjyqësor dhe prokurorial.

Tabela nr. 7 Trajnime të realizuara për stafin administrativ gjyqësor dhe prokurorial

Trajnime për Staf administrativ gjyqësor dhe prokurorial	
Trajnime të realizuar	14
Ditë trajnimi	16
Numri i pjesëmarrësve në total	263
Trajnimet e financuara nga Akademia e Drejtësisë	11
Trajnimet e financuara nga GIZ	2
EUKOJUST	1

III. Programi për Hulumtime dhe Publikime (PHP)

Programi për hulumtime, botime dhe trajnues ka për qëllim zhvillimin profesional të gjyqtarëve, prokurorëve, stafit administrativ gjyqësor dhe prokurorial dhe profesionistëve tjerë ligjor përmes zhvillimit të programeve trajnuese përshtatshëm me nevojat trajnuese si dhe krijimit të botimeve dhe burimeve të reja juridike me theks të praktika gjyqësore përmes hulumtimeve dhe veprimtarisë kërkimore.

Aktivitetet e këtij programi kanë qenë të fokusuar në përgatitjen e raporteve të punës, planeve dhe dokumenteve tjera të rëndësishme që janë kërkesë e ligjit, në krijimin dhe zhvillimin e burimeve të reja juridike, përkatësisht përmbledhjeve të praktikës gjyqësore, përditësimin e bibliotekës elektronike me burime të reja ligjore, mbledhjen dhe përpunimin e të dhënave statistikore dhe aktivitete tjera në funksion të ndarjes së informatave me palët e interesit dhe raportimit institucioneve të sistemit të drejtësisë dhe për mekanizmat tjerë integruar.

3.1 Aktivitetet në PHP

Programi për hulumtime, botime dhe trajnues gjatë vitit 2024 ka qenë i orientuar në aktivitetet si në vijim:

- Vlerësimi të nevojave trajnuese për hartimin e Programit Trajnues dhe Planit të Punës dhe të Performancës së AD-së për vitin 2025
- Veprimtaria botuese për nevoja të zbatimit të programeve trajnuese si dhe për nevoja të sistemit gjyqësor dhe prokurorial;
- Ofrimit të burimeve ligjore sipas kërkesave të përfituesve të AD-së;
- Përgatitja e raporteve në zbatim të masave dhe politikave euro integruar;
- Analiza dhe mbledhja e të dhënave për vlerësimin e performancës së trajnuesve në zbatimin e trajnimeve fillestare dhe të vazhdueshme gjatë vitit 2024

3.2 Zbatimi i procesit për vlerësim të nevojave trajnuese dhe hartimit të Programit Trajnues për vitin 2025;

Vlerësimi i nevojave trajnuese është tejet me rëndësi për Akademinë e Drejtësisë. Është instrumenti thelbësor dhe parakusht për hartimin e një programi trajnues relevant dhe adekuat me nevojat trajnuese të gjyqtarëve, prokurorëve dhe përfituesve tjerë sipas ligjit. Andaj edhe në periudhën raportuese në pajtim me kornizën ligjore në fuqi, neni 6, pika 1.1, 1.2 dhe 1.5 e Ligjit për Akademinë është realizuar procesi i vlerësimit të nevojave trajnuese i cili ka kërkuar përkushtim dhe angazhim gjatë gjithë vitit. Së pari duke përcjellë konkluzionet pas trajnimeve të realizuara sipas kalendarit trajnues 2024 dhe në vijim duke zbatuar mekanizmat tjerë për vlerësim me qëllim që të shterohen gjitha burimet e nevojshme dhe të identifikohen saktë problemet praktike në gjyqësor.

Në këtë proces është përfshirë shqyrtimi i dokumenteve strategjike që kërkojnë nga institucionet e sistemit të drejtësisë përfshirë këtu edhe Akademinë e Drejtësisë angazhim në përmirësim të drejtësisë në shumë kompetenca të punës së gjyqtarëve dhe prokurorëve. Fokus më i madhe i është dhënë masave të cilat e bëjnë përgjegjëse AD-në në Strategjinë për sundimin e Ligjit 2021-2026, Strategjinë për mbrojtjen nga dhuna në familje dhe dhunës ndaj grave 2022-2026 si dhe nga Programi Kombëtar për të Drejtat e Njeriut 2021-2025 dhe priorizimi tyre në programin trajnues të radhës sipas mundësive dhe kapaciteteve të AD-së meqë këto strategji janë obligative për të gjitha institucionet e vendit. Një pjesë e konsiderueshme e masave në këto dokumente e bëjnë Akademinë e Drejtësisë qoftë udhëheqëse ose edhe në bashkëpunim me KGJK dhe KPK duke përfshirë edhe me institucionet e profesioneve të lira.

Krahas shqyrtimit të gjithanshëm të dokumenteve dhe raporteve që monitorojnë sistemin gjyqësor dhe prokurorial është realizuar edhe mbledhja e të dhënave nga anketat vlerësuese të përcjella në gjykata dhe prokurori por edhe pas çdo sesi trajnues të mbajtur në AD. Shqyrtimi i propozimeve nga vizitat dhe takimet në KGJK dhe KPK, gjykata dhe prokurori të mbajtura gjatë gjithë vitit, propozimeve nga takimet e përditshme me trajnuesit me rastin e zbatimit të programeve trajnuese. Veçanërisht thelbësore kanë qenë rezultatet e punëtorisë për vlerësimin e nevojave trajnuese të realizuar me kryetar të gjykatave dhe kryeprokuror të prokurorive gjatë muajit korrik. Në këtë punëtori janë përfshirë edhe përfaqësues nga KGJK dhe KPK në kuadër të cilës është shteruar debati për nevojat trajnuese dhe është përcaktuar kurrikula trajnuese për të gjitha fushat. Rol të rëndësishëm në këtë proces kishte edhe perspektiva e shoqërisë civile dhe mediave të shkruara dhe elektronike për sistemin e drejtësisë.

Ofrimi i rezultateve nga të gjithë mekanizmat e lartpërmendur dhe përgatitja e draftit përmbledhës me raportin analizë të vlerësimit të nevojave trajnuese për Këshillin Programor të AD-së dhe më pas për Këshillin Drejtues ishte aktiviteti i fundit në këtë proces për vlerësim të nevojave trajnuese.

3.3 Veprimtaria botuese dhe publikimi

Veprimtaria botuese e dhe e publikimit të AD-së ka qenë e orientuar në botime për nevoja të gjyqtarëve, prokurorëve dhe profesionistëve ligjor në zbatimin praktik të legjislacionit në fuqi, nevoja të zbatimit të programeve trajnuese si dhe të karakterit informues apo periodike siq janë raportet, plani i punës, buletini dhe raportet nga aktivitetet trajnuese, konferencat, tryezat e punës, tryezat e diskutimeve dhe tubimet e tjera profesionale

Për aspektin e botimeve dhe veçanërisht në krijimin e burimeve të reja juridike që lehtësojnë punën e gjyqtarëve dhe profesionistëve tjerë ligjor në zbatimin praktik të legjislacionit në fuqi është punuar ngushtë me Gjykatën Supreme të Kosovës dhe KGJK-në, pa përjashtuar edhe gjyqtarët dhe prokurorët që kanë shfaqë interes në këtë fushë. Këtij procesi i ka paraprirë takimi i përbashkët i vlerësimit të nevojave për botime të reja dhe kryesisht në lëminë e praktikës gjyqësore për unifikimin e saj pasi janë identifikuar shkelje të shpeshta të dispozitave materiale dhe procedurale të ligjit nga gjykatat e instancave më të ulta. Nga gjetjet e praktikës gjyqësore dhe me qëllim adresimin e tyre janë zhvilluar dy botime si:

- ***Përmbledhje nga Praktika e Gjykatës Supreme të Kosovës në çështje civile dhe penale si dhe***
- ***Vendime të përzgjedhura të Gjykatës Supreme të Kosovës.***

Të dy botimet janë përkthyer edhe në serbisht dhe janë të qasshme për gjithë gjyqtarët dhe profesionistët ligjor. Printimi i këtyre botimeve e ka mundësuar projekti Western Balkans Rule of Law Initiative (WBROLI) Chemonics.

Këto botime shërbejnë si udhërrëfyese për unifikimin e praktikës gjyqësore pasi përmbajnë praktikën gjyqësore të lëndëve të kthyer në rigjykim dhe të ndryshuara duke përfshirë edhe udhëzimet se si të veprohet në situatat e ngjashme konform dispozitave ligjore dhe gjithashtu praktikat dhe standardet e Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (GJEDNJ).

Në periudhën raportuese është iniciuar edhe botimi i një udhëzuesi për provat elektronike nga disa gjyqtarë. Ky dokument është në proces të hartimit meqë janë identifikuar çështjet ligjore që do të trajtohen në kuadër të këtij botimi dhe autorët përkatës ndërkaq, finalizimi i tij pritët më së largu në katër mujorin e parë të viti 2025.

Në funksion të zbatimit të Programit të Trajnimit Fillestar për 15 gjyqtarët e gjeneratës së XI dhe 32 gjyqtarët e gjeneratës së XII, janë realizuar modulet si në vijim:

- Moduli: Kodi Penal;
- Moduli: Kodi i Procedurës Penale;
- Moduli: Rendi Juridik Kombëtar dhe Ndërkombëtar;
- Moduli: Legjislacioni dhe shkathtësitë plotësuese;
- Moduli: Shkathtësitë personale dhe ndër personale;
- Moduli: E drejta civile administrative dhe ekonomike;

Në funksion të rritjes së kapaciteteve profesionale të bashkëpunëtorëve profesional të gjykatave dhe prokurorive dhe veçanërisht stafit të ri në këto pozita është rishtypë Moduli bazik në fushën penale materiale dhe procedurale si dhe Moduli bazik në fushën civile materiale dhe procedurale. AD ka rishtyp botimin përkatës në sasi prej 199 copë, prej tyre në 169 copë në gjuhën shqipe dhe 30 në gjuhën serbe dhe të njëjtat janë shpërndarë dhe vazhdojnë edhe më tej gjatë trajnimeve për këto kategori.

Nuk është arrite të publikohet buletini informativ i cili në baza periodike është publikuar për vite me radhë për shkak të mos funksionalizimit të plotë të platformës së re për menaxhimin e të dhënave. Kompania kontraktuese e AD-së është duke vazhduar edhe më tej në eliminimin e pengesave sipas kontratës.

Për nevoja të funksionimit dhe zhvillimit të veprimtarisë së AD-së janë krijuar dhe zhvilluar botimet si në vijim:

- Raporti vjetor i punës dhe i performancës së AD-së për vitin 2023
- Programi i Trajnimit për vitin 2025
- Programi i Trajnimit Fillestar për gjyqtarët e sapo emëruar, gjenerata e XI
- Programi i Trajnimit Fillestar për gjyqtarët e sapo emëruar, gjenerata e XII
- Plani i punës dhe i performancës për vitin 2025 i AD-së
- Plani i Integritetit të AD-së për vitin 2024-2026.

Për dizajnimin dhe shtypjen e botimeve të lartpërmendura është punuar ngushtë edhe me kompaninë kontraktuese të AD-së. Deri në muajin gusht 2024 ka qenë në zbatim kontrata me numër të aktivitetit të prokurimit: **UA/2016-23-7230-1-2-1/C370** e cila ka pasur kohëzgjatje nga: **31.08.2023 deri me 30.08.2024**. Vlera totale e kontratës ishte **22,666.00€**.

Nga kjo kontratë nga periudha janar-gusht 2024 janë realizuar 12 porosi për publikime sipas specifikave teknike të parapara në kontratë me gjithësejt 2,017.1 €

Nga muaji nëntor 2024 ka qenë në zbatim kontrata e re me nr. **UA/2016-24-9791-5-5-8/C586** e cila është në vlerë prej 16,879.56 € dhe vlen deri në nëntor të vitit 2025. Nga kjo kontratë janë realizuar edhe 4 porosi për publikime me gjithsej 239.86 € të cilat ishin kryesisht module të trajnimit në funksion të Programit të Trajnimit Fillestar për gjeneratën e XII të gjyqtarëve si dhe Programi Fillestar për prokurorët që priten të dekretohen së shpejti dhe për AD-në përbëjnë gjeneratën e XI.

3.4 Ofrimi i burimeve ligjore vendore dhe qasjes në burime ligjore nga rrafshi ndërkombëtarë

Akademia e Drejtësisë disponon me bibliotekën ligjore elektronike e cila është në shërbim të përfituesve të saj sipas ligjit. Për të gjithë komunitetin ligjor që kanë shprehur interes për materialet ligjore që gjenden në këtë platformë i është ofruar asistencë dhe mbështetje praktike. Kërkesat për materiale ligjore edhe për vitin 2025 kanë qenë kryesisht në kategorinë e komentarëve ligjor, përmbledhjeve të praktikës gjyqësore dhe doracakëve dhe kjo më tepër nga praktikantët e gjykatave, bashkëpunëtorët profesional dhe studentet e më pak nga gjyqtarët dhe prokurorët, meqenëse gjyqtarët dhe prokurorët janë të pajisur me formatet fizike. Biblioteka ligjore e materialeve në kopje fizike ka vazhduar të mos jetë e kërkueshme.

AD ka vazhduar anëtarësimin e saj në Asociacionin e Bibliotekave Elektronike për të përfituar edhe më tej abonimin në data baza ndërkombëtare që përfituesve të saj t’iu ofrohen edhe resurse dhe burime ligjore nga rrafshi ndërkombëtarë. Si rezultat ka vazhduar qasja në data bazat e natyrës ligjore dhe të përgjithshme si në vijim:

- **IOP science** që ka mundësuar studiuesit të hyjnë në përmbajtje shkencore, teknike dhe mjekësore.
- **Autoritetet shkencore të Oksfordit për të drejtën ndërkombëtare** e cila ka përfshirë traktatet autoriteteve, të cilat vazhdojnë definimin e fushave të tyre të së drejtës, punimet referuese dhe komentaret e Black-letter që ndihmojnë në përgjigjen ndaj disa pyetjeve praktike të së drejtës dhe publikime të cilat ofrojnë këndvështrime inovative për problemet aktuale ligjore.
- **Enciklopedia e Max Planck për të Drejtën Publike Ndërkombëtare** që ka ofruar artikuj enciklopedik lidhur me më shumë se 1600 çështje ligjore ndërkombëtare, koncepte dhe raste.
- **Publikimet Edward Elgar** që ka ofruar e-libra dhe revista të publikuara mbi ligjin, biznesin, ekonominë dhe shkencat sociale.
- **Revistat online të Cambridge** që ka ofruar qasje në koleksionin multi-diciplinor mbi 330 revista të cilat mbulojnë temat mbi shkencën, teknologjinë, mjekësinë, humanizmin dhe shkencat sociale.
- **OECD-iLibrary** e integruar për libra, revista, punime dhe statistika
- **eBiblioteka e Fondit Monetar Ndërkombëtar** – që ka siguruar qasje të fuqishme dhe të përshtatshme në internet për mbledhjen e plotë të përmbajtjes autoritative ekonomike globale të publikuara nga Fondi Monetar Ndërkombëtar (FMN). Me më shumë se 11,000 botime të tekstit dhe qasje të plotë tek bazat e të dhënave statistikore të FMN-së.
- **Baza Evropiane e të Dhënave të Jurisprudencës së të Drejtave të Njeriut për vendet e Evropës Juglindore.** Kjo data bazë ka ofruar vendime të Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut,

përmbledhje të çështjeve të rëndësishme për rajonin në gjuhët lokale si dhe botime tjera si manuale dhe udhëzues të praktikës gjyqësore të Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut.

3.5 Hartimi i raporteve në baza periodike në zbatim të masave dhe politikave euro integruese

Edhe në periudhën raportuese Akademia e Drejtësisë ka vazhduar përkushtimin e saj në zbatimin e masave dhe kërkesave nga dokumentet strategjike në nivel nacional dhe në përgatitjen e raporteve në baza periodike për Strategjinë për sundimin e Ligjit, Strategjinë për mbrojtjen nga dhuna në familje, Programin Kombëtar për të Drejtat e njeriut dhe dokumente tjera strategjike në nivel nacional të cilat janë si rrjedhojë e MSA-së dhe raportit të BE-së për Kosovën. Në vazhdimësi janë hartuar raportet në baza të rregullta për institucionet dhe mekanizmat përkatës për çka nga raportet e ndryshme veçanërisht të strategjive të lartëpërmendura të cilat Akademinë e Drejtësisë për kundër kapaciteteve të limituara qoftë njerëzore ashtu edhe financiare e vendosin në institucionet më të përgjegjshme si në zbatim ashtu edhe në raportimin e masave.

Përveç mekanizmave integruar në BE, Akademia e Drejtësisë në vazhdimësi ka bashkëpunuar me KGJK dhe KPK dhe njësitë për shqyrtimin e performancës së gjyqtarëve dhe prokurorëve që veprojnë në kuadër të dy këshillave duke i ofruar të dhëna mbi vijueshmërinë e gjyqtarëve dhe prokurorëve në trajnime. Gjithashtu për nevojat e raportimit ose edhe të prezantimit institucional në konferenca, takime dhe forma tjera janë nxjerrë të dhëna statistikore për aktivitetet trajnuese dhe detajet tjera që tregojnë angazhimin e Akademisë në ngritje të kapaciteteve të gjyqtarëve, prokurorëve dhe përfituesve tjerë sipas ligjit.

3.6 Analiza dhe mbledhja e të dhënave për vlerësimin e performancës së trajnuesve në zbatimin e trajnimeve fillestare dhe të vazhdueshme gjatë vitit 2024

Në periudhën raportuese në pajtim me Rregulloren Nr. 02/2019 për Trajnues dhe Mentorët e AD-së si dhe rregullores Nr. 01/2023 për plotësimin dhe ndryshimin e rregullores nr. 02/2019 është punuar në mbledhjen dhe analizën e të dhënave për trajnuesit e caktuar nga Këshilli Drejtues për zbatimin e trajnimeve sipas programit të trajnimeve fillestare dhe të vazhdueshme. Bazuar në kriteret dhe indikatorët e rregullores përkatëse janë mbledhë gjitha të dhënat sa i përket kontributit të trajnuesve në hartimin e planit dhe programit vjetor të trajnimit, përgatitjet paraprake sa i përket materialeve trajnuese dhe dokumenteve tjera përcjellëse si dhe me rastin e zbatimit të trajnimeve edhe vlerësimet e tyre nga pjesëmarrësit dhe stafi.

Nga gjetjet e data bazës SMAT dhe burimeve tjera brenda AD-së, përkatësisht nga kuadri ligjor përgjegjës kanë rezultuar që nga lista e trajnuesve prej 142 sa janë gjithësejt² përfshirë edhe dy trajnuesit e përhershëm të AD-së gjatë vitit 2024 janë angazhuar 79 trajnues të cilët kryesisht ishin nga radhët e gjyqtarëve dhe prokurorëve dhe më pak nga profesionistët e tjerë ligjor.

² <https://ad.rks-gov.net/lista-e-trajnuesve-te-perkohshem>

Për 79 trajnuesit është përgatitur raporti i performancës³ dhe sipas indikatorëve dhe kriterëve të rregullores është bërë vlerësimi i performancës fillimisht nga Këshilli Programor dhe më pastaj edhe nga Këshillin Drejtues.

Në periudhën raportuese ka qenë në shfrytëzim data baza e re SMAT e cila synon të jetë më efikase dhe më e avancuar por që ende nuk e ka arritur funksionalitetin e saj të plotë meqë ende ka vazhduar zhvillimi i moduleve sipas kontratës me kompaninë kontraktuese.

IV. Aktivitetet në Departamenti Ligjore dhe shërbime të përgjithshme dhe Divizionet të tjerat

Aktivitetet në Departamentin për Shërbime Ligjore dhe të Përgjithshme, brenda përgjegjësi dhe me kompetence ka vazhduar në ofrimin e shërbimeve dhe mbështetjes për Këshillin Drejtues, Këshillin Programor, Departamentin e Programeve si dhe divizioneve të tjera të AD. Gjatë vitit 2024 sipas planit të punës, aktivitete të departamentit janë fokusuar në vazhdimin e përmbushjes së reformës së administratës publike, reformës legjislative sipas pakos së ligjeve për drejtësinë duke përfshirë edhe plotësimin ndryshimet e ligjit të AD. Në mbështetje të punës së KD janë organizuar 8 takime, ndërsa në mbështetje të punës së KP janë organizuar 5 takime, ndërsa aktivitete të shtura janë ndërmarrë shërbimet e teknologjisë së informacionit, sigurimin e kushteve fizike të punës, pajisjet e nevojshme, si dhe shërbimet mbështetëse dhe logjistike, në bashkëpunimin ndërinstitucional dhe komunikim.

Shërbimet ligjore, komunikimi, bashkëpunimi ndër-institucional, shërbimet e teknologjisë së informacionit, shërbimet mbështetëse dhe logjistike sipas kompetencës janë fokusuar në realizimin e të gjitha aktiviteteve të planifikuara sipas planit të punës për vitin 2024 dhe planit të performancës, dhe atë si në vijim:

- Shërbimet Ligjore
 - Hartimi i Rregullores Nr. 01/2024 për Trajnimin Fillestar.
 - Hartimi i Rregullores Nr. 01/2023 për Plotësim dhe Ndryshim të Rregullores Nr. 02/2019 për Trajnuesit dhe Mentorët e Akademisë së Drejtësisë.
 - Pjesëmarrja dhe dhënia e kontributeve në Grupin Punues për hartimin e Projektligjit të Akademisë së Drejtësisë të themeluar nga Ministria e Drejtësisë dhe në dokumentin për konsultim publik;
 - Hartimi i Memorandumit të Bashkëpunimit me Ministrinë e Drejtësisë dhe Oden e Ndërmjetësuesve për zhvillimin e trajnimeve rifreskuese për ndërmjetësues.
- Organizimi i Takimeve të Organeve Drejtues
 - Organizimi dhe mbarëvajtja e tetë (8) takimeve të Këshillit Drejtues.
 - Organizimi dhe mbarëvajtja e pesë (5) takimeve të Këshillit Programor të Akademisë së Drejtësisë.
- Teknologjia e Informacionit
 - Mirëmbajtja dhe administrimi i vazhdueshëm i pajisjeve të teknologjisë së informacionit, si: kompjuterë, laptopë, smartboard, serverë, telefonia fikse dhe pajisje të tjera.
 - Mbështetja e vazhdueshme për stafin në çështjet që lidhen me teknologjinë informative.

³ Vlerësimi i performancës është bërë vetëm për trajnuesit sipas listës së trajnuesve dhe jo për trajnuesit të cilët janë sjellë si ekspertizë e huaj si rezultat i projekteve me donatorë

- Gjatë trajnimeve në PTF, sallat janë pajisur me laptopë dhe pjesëmarrësit i kanë përfunduar materialet, detyrat dhe vlerësimet në mënyrë digjitale/online përmes sistemit për Menaxhimin e Aktivitetit Trajnues (SMAT). Trajnuesit gjithashtu kanë përfunduar vlerësimet e detyrave dhe të tjera në mënyrë online përmes këtij sistemi.
- Blerja e pesë (5) kompjuterëve për stafin e ri të Akademisë së Drejtësisë.
- Blerja dhe montimi i dy seteve të pajisjeve të përkthimit në dy salla të AD-së.
- Blerja e pesë (5) pajisjeve UPS për stafin e Akademisë së Drejtësisë;
- Komunikimi dhe Informimi
- Përditësimi i vazhdueshëm i ueb-faqes zyrtare dhe rrjeteve sociale të Akademisë me informacione të reja.
- Lëshimi online, në dy periudha, i kursit trajnues në platformën e mësimin në distancë për Hetime Financiare dhe Kthim të Pasurisë;
- Publikimi i akteve nënligjore të miratuara nga Këshilli Drejtues si dhe dokumenteve strategjike.
- Mbështetja Logjistike
- Mbështetja administrative, teknike dhe logjistike për të gjitha aktivitetet e organizuara nga AD.
- Arkivimi i dokumenteve, materialeve dhe shkresave të AD-së

4.1 Njësia për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore

Prioritet i Njesisë për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore (NJBNI) gjatë vitit 2024 ka qenë zbatimi dhe përmbyllja e procesit të kërkesave të dala nga reforma e administratës publike, respektivisht zbatimi i Ligjit Nr.08/L-197 për Zyrtarët Publikë, si dhe Rregullores nr.05/2023 për Organizimin e Brendshëm dhe Sistematizimin e vendeve të punës. NJBNI në pajtim me dispozitat e Ligjit Nr.08/L-197 për Zyrtarët Publikë, Rregullores Nr. 14/2020 për Transferimin e Nëpunësve Civilë, si dhe Rregullores nr.05/2023 për Organizimin e Brendshëm dhe Sistematizimin e vendeve të punës në AD, ka përfunduar procesin e ristrukturimit të secilit nëpunës civil të Akademisë së Drejtësisë. Akademia e Drejtësisë aktualisht ka 36 pozita të miratuara sipas Rregullores për Organizimin dhe Sistematizimin e vendeve të punës ndërsa, vetëm 32 janë të lejuara dhe të parapara me ligjin për buxhetin për vitin 2024. Në këtë kontekst në harmoni me përcaktimet e LZP-së, si dhe Ligjit për Paga në Sektorin Publik janë lëshuar aktet e reja të emërimit për të gjithë nëpunësit civil të Akademisë së Drejtësisë.

Në fillim të vitit 2024, Akademia e Drejtësisë ka pasur të punësuar gjithsejtë 25 (njëzetepesë) zyrtarë, ndërkaq të aprovuara kanë qenë gjithsejtë 32 (tridhjetedy) pozita, ndërsa në fund të vitit 2024 janë gjithsejtë 29 (njëzetëntë) zyrtarë, ku një nga këto pozita fillon punën nga data 03 janar 2025 deri sa akt emërimi është nënshkruar me datë 27.12.2024. Në muajin prill 1 (një) zyrtar është kthyer nga pushimi pa pagesë, në muajin nëntor 1 (një) nëpunës është kthyer nga pushimi i lehonisë, si dhe 2 (dy) nëpunës kanë dhënë dorëheqje.

Tabela 1: Pozitat e aprovuara për vitin 2024

Kategoria funksionale				
Nivel i lartë drejtues	Niveli i mesëm drejtues	Niveli i ulët drejtues	Niveli profesional	Total

Gjithashtu, gjatë këtij viti NJMBNJ ka zhvilluar gjithsej 14 procedura të rekrutimit, ku prej tyre 9 procedura kanë përfunduar me sukses dhe 5 procedura kanë rezultuar pa kandidat fitues. Andaj, në vazhdim të këtij procesi është hartuar planifikimi i rekrutimit edhe për 3 pozitat e lira në AD për vitin 2025 ndërsa, sfiduese ka vazhduar të jetë buxheti i pamjaftueshëm, respektivisht sigurimi i buxhetit për 4 pozita të reja të miratuara me Rregulloren nr.05/2023 për Organizimin e Brendshëm dhe Sistematizimin e vendeve të punës në AD.

Tabela 2: Rekrutimet gjatë vitit 2024

Procedurat e rekrutimit 2024			
Kategori përfituese	Procedurat për rekrutim të zhvilluara në vitin 2024	Procedurat për rekrutim të përfunduara me sukses në vitin 2024	Procedurat për rekrutim të dështuara në vitin 2024
Niveli i mesëm drejtues	5	2	3
Niveli i ulët drejtues	4	3	1
Niveli profesional	5	4	1
Niveli i mesëm drejtues	5	2	3
Niveli i ulët drejtues	4	3	1

Ndërsa, ngritja e kapaciteteve profesionale është fokusuar në trajnimet bazuar në legjislacion e administratës publike, me theks të veçantë për stafin e rekrutuar të cilët nuk kanë qenë më herët pjesë e Shërbimit Civil.

4.2 Teknologjia Informative

Divizioni i Teknologjisë Informative është i përkushtuar për digjitalizimin e shërbimeve, avancimin dhe mirëmbajtjen e pajisjeve dhe sistemeve në Akademinë e Drejtësisë

Divizioni i TI-së ka vazhduar rregullisht në realizimin e aktiviteteve në vijim:

- Mirëmbajtja dhe administrim i vazhdueshëm i pajisjeve të teknologjisë informative si kompjuterë, llaptop, smartboard, server, telefonia fikse dhe pajisjeve tjera.
- Është mbështetur vazhdimisht stafi gjatë punës me çështjet që kanë të bëjnë me teknologji informative.
- Gjatë trajnimeve në PTF sallat janë pajisur me laptop dhe pjesëmarrësit: materialet, detyrat, vlerësimet i kanë përfunduar në mënyrë digjitale/online përmes sistemit për Menaxhimin e Aktiviteteve Trajnuese (SMAT). Gjithashtu trajnuesit vlerësimet e detyrave dhe vlerësimet tjera i kanë përfunduar në mënyrë online përmes këtij sistemi.
- Gjatë këtij viti janë blerë 5 kompjuter për stafin e ri të Akademisë së Drejtësisë.
- Gjatë këtij viti janë blerë dy sete të pajisjeve të përkthimit dhe janë montuar në dy salla të AD-së.
- Janë blerë 5 UPS për stafin e Akademisë së Drejtësisë.
- Ueb faqja zyrtare dhe rrjetet tjera sociale të Akademisë vazhdimisht janë freskuar me informata të reja.

- Gjatë këtij viti është lëshuar online në dy periudha kursi trajnues në platformën e mësimi në distancë: Hetime Financiare dhe kthim i pasurisë.

4.3 Prokurimi:

Sipas ndryshimeve ligjore në fushën e Prokurimit Publik në Kosovë, Ligji Nr. 04-L-042, për Prokurim Publik në Kosovë, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr. 04/L-237, Ligjin Nr. 05/L-068 dhe Ligjin Nr. 05/L-092, sipas nenit 21/A, Akademia e Drejtësisë si Institucion me më pak se 50 nëpunës nuk ka të drejtë të zhvilloj procedura të prokurimit, kjo kompetencë është bartur tek Agjencia Qendrore e Prokurimit. Andaj Akademia e Drejtësisë ka kompetencë të:

- Hartoj planifikimi paraprak të prokurimit dhe planifikimi përfundimtar të prokurimit për periudhën Janar - Dhjetor 2024;
 - Të dërgoj kërkesat për zhvillim të procedurave të prokurimit në Agjencinë Qendrore të Prokurimit(AQP) për aktivitete e prokurimit të cilat i ka planifikuar AD-ja.
 - Të menaxhoj kontratat e pranuar nga AQP
 - Të përgatit draft-vendimet për menaxher të kontratave dhe mbikëqyrësve të drejtpërdrejt të menaxherit të kontratës si dhe draft-vendimet për pranim të mallit.
 - Të bëjë ekzekutimin e urdhër blerjeve për shërbime dhe furnizime të ndryshme;

Aktivitete e prokurimit të planifikuara për vitin 2024:

- Furnizim me pajisje të Teknologjisë Informative-Furnizim me pajisje të përkthimit
- Furnizim me pajisje të Teknologjisë Informative-Furnizim me PC dhe UPS
- Furnizim me karburante për vetura
- Furnizim me karburante për ngrohje dhe gjenerator
- Furnizim me materiale të shtypura dhe dizajn(botime dhe publikime)
- Furnizim me letër për kopje
- Furnizim me material të ndryshëm zyrtar
- Furnizim me artikuj të ndryshëm ushqimor-furnizim me produkte për kafiteri
- Shërbime të akomodimit, ushqimit dhe pijeve për pjesëmarrësit në trajnime në Prishtinë dhe Brezovicë-Prevallë
- Servisimi dhe mirëmbajtja e automjeteve
- Shërbime të sigurimit fizik të objektit
- Shërbime të pastrimit dhe mirëmbajtjes së objektit
- Shërbime të transportit ajror
- Shërbime të fotokopjimit dhe printerëve me qira

Kontrata e nënshkruara nga AQP për Nivelin Qendror dhe për Agjencitë e Pavarura:

- Furnizim me karburante për vetura-lot 2

- Furnizim me karburante për ngrohje dhe gjenerator-shfrytëzimi i kontratës te nivelit lokal-Komuna e Prishtinës
- Furnizim me vetura për Institucionet e Republikës së Kosovës
- Furnizim me materiale të shtypura-botime dhe publikime
- Furnizim me mobilje-Lot 2-Furnizim me karrige
- Furnizim me mobilje-Lot 1-Furnizim me tavolina pune dhe dollap
- Furnizim me material të ndryshëm zyrtar
- Furnizim me letër për kopje
- Shërbime të transportit ajror
- Furnizim me material zyrtar për Agjencitë e Pavarura
- Furnizim me pajisje të Teknologjisë Informative-Furnizim me pajisje të përkthimit
- Furnizim me pajisje të Teknologjisë Informative-Furnizim me PC dhe UPS
- Furnizim me qumësht dhe produkte të qumështit-lot 3
- Furnizim me artikuj të ndryshëm ushqimor-Lot 5
- Furnizim me artikuj të ndryshëm ushqimor-Lot 4
- Servisimi dhe mirëmbajtja e automjeteve
- Shërbime të sigurimit fizik të objektit
- Shërbime të pastrimit dhe mirëmbajtjes së objektit
- Shërbime të fotokopjimit dhe printerëve me qira

Buxheti dhe Financat:

Ne mbështetje të Ligjit mbi Ndarjet Buxhetore për Buxhetin e Republikës së Kosovës, buxheti i aprovuar për Akademinë Drejtësisë për vitin 2024 ishte 863,244.98 euro, planifikimeve dhe shpenzimeve në kategoritë ekonomike. Ne përputhje me objektivat e divizionit, aktivitet gjatë vitit 2024 janë realizuar si ne vijim:

- Janë përgatitur pasqyrat vjetore financiare për vitin 2023;
- Është përgatitur pyetësori për vetëvlerësim për vitin 2023;
- Është përgatitur rrjedha e parasë së gatshme për vitin 2024;
- Është përgatitur Korniza Afatmesme e Shpenzimeve dhe Buxheti për periudhën 2025-2027;
- Janë bërë barazimet periodike të shpenzimeve me thesar;
- Janë përgatitur raporte të ndryshme periodike financiare;
- Të gjitha shpenzimet e proceduara për këtë periudhë janë regjistruar në databazën e brendshme të financave dhe në SIMFK.

Auditimi

Gjatë vitit 2024, është realizuar auditimi nga Zyra Kombëtare e Auditorit. Rekomandimet e Zyrës Kombëtare të Auditorit janë pjesë e këtij raporti.

1.1 Pagesat nga palët e treta

Në zbatim të SNKSP 2017 pagesat nga palët e treta shpalosen në shënimin 13.

1.2 Shumat raportuese

Shumat raportuese nga neni:

13 deri te neni 15 janë në `000 (mijë) Euro (€),

16 deri te neni 24 shumat janë shuma e plotë Euro (€).

1.3 Valuta raportuese

Shumat janë raportuar në valutën Euro (€),

1.4 Data e autorizimit

Autorizohen me datën e nënshkrimit te deklaratës për Pasqyrat Financiare nga Zyrtari Kryesore Administrativë dhe Zyrtari Kryesore Financiar.

Neni 14.6

Shpalosja e ndarjeve fillestare dhe finale të buxhetit

Kategoria e ndarjes	Ndryshimet e autorizuar nga LMFP								Buxheti përfundimtar SIMFK € '000	Ndryshimet e buxhetit fillestar € '000
	Buxheti Fillestar (Ligji i Buxhetit) € '000	Vendimi i Qeverisë 14/238,date 18.12.2024 € '000	Vendimi i Qeverisë 03/239,date 24.12.2024 € '000	Ndrysi himi III € '000	Ndrysi himi IV € '000	Të hyrat vetanake € '000	Grantet e percaktuara te donetoreve € '000	Burime tjera te financimit € '000		
Hyrjet										
Të hyrat tatimore									-	#DIV/0!
Të hyrat jo tatimore									-	#DIV/0!
Të hyrat e dedikuara							0		0	#DIV/0!
Grantet e përcaktuara të donatorëve									-	#DIV/0!
Huamarrjet									-	#DIV/0!
Tjera									-	#DIV/0!
Gjithsej	-	-	-	-		-	0	-	0	#DIV/0!
Daljet										
Paga dhe shtesa	277		(22)						255	(0.08)
Mallra dhe shërbime	520	(100)					4		424	(0.18)
Shpenzime komunale	17	(6)							11	(0.33)
Transfere dhe subvencione	-								-	#DIV/0!
Shpenzime kapitale	50								50	-
Rezerva	-									#DIV/0!
Kthimi i huamarrjeve	-								-	#DIV/0!
Tjerat	-								-	#DIV/0!
Gjithsej	863	(106)	(22)	0		0	4	0	740	-14.3%

Me Ligjin mbi Ndarjet Buxhetore për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2024, buxheti fillestar për këtë vit ka qenë 863,244.98 euro, për të gjitha kategoritë ekonomike përfshirë këtu pagat dhe mëditje, mallrat dhe shërbimet, shpenzime komunale dhe shpenzime kapitale.

Totali i donacioneve të realizuare për vitin 2024 ka qenë 4,043.60 euro dhe janë donacion nga UNDP, nga të cilat 43.60 euro janë bartje nga viti i 2023.

Buxheti përfundimtar për vitin 2024 në të gjitha kategoritë në vlerë prej 739,643.38 euro (BKK 735,599.78 + donacione 4,043.60):

- Paga dhe shtesa, buxheti ka qenë 276,796.98 euro, ndërsa sipas vendimit të datës 24.12.2024 me numër 03/239 të Qeverisë së Republikës së Kosovës është reduktuar buxheti në këtë kategori për 22,145.20 euro që do të thotë se buxheti përfundimtar është në vlerë prej 254,651.78 euro,
- Mallra dhe shërbime, buxheti ka qenë 519,948.00 euro, ndërsa sipas vendimit të datës 18.12.2024 me numër 14/238 të Qeverisë së Republikës së Kosovës është reduktuar buxheti në këtë kategori për 100,000.00 euro, buxheti përfundimtar në këtë kategori është 423,399.16 euro prej të cilave 419,948.00 janë nga buxheti dhe 4,043.60 euro janë donacion nga UNDP,
- Shpenzime komunal, buxheti ka qenë 16,500.00 euro, ndërsa sipas vendimit të datës 18.12.2024 me numër 14/238 të Qeverisë së Republikës së Kosovës është reduktuar buxheti në këtë kategori për 5,500.00 euro, buxheti përfundimtar në këtë kategori është 11,000.00 euro,
- Shpenzime kapitale, buxheti ka qenë 50,000.00 euro.

Shënimi 2 Paga dhe shtesa

Përshkrimi	2024									2023	2022	
	Gjithsej								Buxheti			Ndryshimi
	Pagesat	FH	KI	FZHM	GQ	THV	THD	GPD	Final			Buxheti - Pagesat
	€ '000	€ '000	€ '000	€ '000	€ '000	€ '000	€ '000	€ '000	€ '000	€ '000	€ '000	
Paga Neto	203				203						194	180
Pagat neto përmes listës së pagave	-											
Pagesa per sindikatë	-											
Tatimi në të ardhurat personale	14				14						14	12
Antarësimi -Oda e infermierëve të Kosovës	-											
Antarësimi -Oda e mjekëve të Kosovës	-											
Kontributi pensional - punëtori	12				12						11	10
Punëtorët me kontratë (jo në listën e pagave)	-											
Shtesa e përformancës	-											
Shtesa për kushte specifike	-											
Shtesa për punën pa orar të paracaktuar	-											
Shtesa për vëllimin e punës	-											
Shtesa për nëpunësin e sistemit shëndetësor	-											
Shtesa funksionale për arsimin universitar	-											
Shtesa funksionale për shëndetësi	-											
Kujdestaria, puna gjatë natës dhe puna jashtë orarit të punës	-											
Funksionet shtesë	-											
Anetarët e shërbimit të jashtëm	-											
Stafi i administratës që punon jashtë vendit	-											
Funksionarët me kohe të pjesshme	-											
Tatimi i ndaluar në të ardhura personale	-											
Kontributi pensional-punëtori	-											
Shtesat tranzitore	13				13							
Kontributi pensional-punëdhënësi	12				12						11	10
Vendimet e gjykatave	-											
Paga dhe shtesa	254	-	-	-	254	-	-	-	255	0	229	213

Buxheti fillestar në paga dhe mëditje ka qenë 276,796.98 euro, ndërsa sipas vendimit të datës 24.12.2024 me numër 03/239 të Qeverisë së Republikës së Kosovës është reduktuar buxheti në këtë kategori për 22,145.20 euro që do të thotë se buxheti përfundimtar është në vlerë prej 254,651.78 euro. Në kuadër të shpenzimeve për paga dhe mëditje përfshihen pagat e stafit të AD, shpenzimet për anëtarët e Këshillit Drejtues të AD-së, shpenzimet për tatim dhe kontribute.

Mjetet e mbetura në këtë kategori janë mjetet nga pozitat e lira, të cilat nuk kanë arritur të plotësohen gjatë viti 2024.

Shënimi 3 Mallra dhe shërbime

Përshkrimi	Gjithsej								Buxheti	Ndryshimi Buxheti - Pagesat	2023	2022
	Pagesat € '000	FH € '000	KI € '000	FZHM € '000	GQ € '000	THV € '000	THD € '000	GPD € '000	Final € '000	Pagesat € '000	€ '000	€ '000
Shpenzimet e udhëtimit zyrtar brenda vendit	-											
Meditjet për udhëtime zyrtre brenda vendit	-											
Akomodimi udhëtime zyrtre brenda vendit	-											
Shpenzime tjera për udhëtime zyrtre brenda vendit	-											
Shpenzimet e udhëtimit zyrtar jashtë vendit	-											
Meditjet për udhëtime zyrtre jashtë vendit	6				6						6	4
Akomodimi udhëtime zyrtre jashtë vendit	1				1						0	
Shpenzime tjera udhëtime zyrtre jashtë vendit	0				0						0	1
Telefonisa mobile	2				2						2	2
Shpenzimet postare	-				-						-	-
Shërbimet e arsimit trajnimit	158				154			4			189	173
Shërbime të ndryshme shëndetsore	-				-						-	-
Shërbime të ndryshme intelektuale dhe këshilldhënëse	7				7						4	3
Sherbime shtypje-jo marketing	-				-						-	-
Sherbime kontraktuese tjera	36				36						25	35
Mobilje (me pak se 1000 euro)	1				1						1	4
Pajisje tjera	3				3						-	-
Furnizime per zyre	1				1						8	3
Furnizime me ushqim,pije(jo dreke zyrtare)	3				3						4	4
Furnizime pastrimi	-				-						-	-
Nafte per ngrohje qendrore	15				15						20	15
Derivate per gjenerator	-				-						-	2
Karburant per vetura	1				1						2	4
Sigurimi I automjeteve	2				2						1	0
Taksat Komunale e Regjistrimit te automjeteve	-										-	-
Sigurimi I ndertesave dhe tjera	14				14						12	12
Regjistrimi I automjeteve	1				1						0	0
Mirembajtje dhe riparim I automjeteve	1				1						0	1
Mirembajtje e ndertesave	7				7						7	8
Mirembajtje e tekonologjise informative	-				-						-	1
Mirembajtje e mobiljeve dhe pajisjeve	0				0						0	2
Qiraja e ndertesave	90				90						90	81
Qiraja e pajisjeve	3				3						3	2
Qiraja per makineri	1				1						12	16
Reklamat dhe konkurset	-				-						-	-
Botimet e publikimeve	2				2						11	10
Drekat zyrtare	0				0						0	0
Shpenzimet - Vendimet e Gjykatave	0				0						-	6
Mallra dhe shërbime	354	-	-	-	350	-	-	4	424	70	398	388

Buxheti fillestar për mallra dhe shërbime, ka qenë 519,948.00 euro, ndryshimet në mes të buxhetit fillestar dhe buxhetit përfundimtarë në kuadër të kësaj kategorie janë si rrjedhojë e donacioneve dhe e reduktimeve buxhetore.

Buxheti përfundimtar në këtë kategori është 423,399.16 euro prej të cilave 419,948.00 janë nga buxheti dhe 4,043.60 euro janë donacion nga UNDP, ndërsa sipas vendimit të datës 18.12.2024 me numër 14/238 të Qeverisë së Republikës së Kosovës është reduktuar buxheti në këtë kategori për 100,000.00 euro.

Kategoria e mallrave dhe shërbimeve është kategori e cila përfshinë një pjesë të madhe të alokimit dhe shpenzimit të mjeteve në kuadër të buxhetit të AD.

Me qe nëse AD merret me trajnime profesionale për gjyqtarë, prokurorë, dhe profesionist tjerë të identifikuar nga AD, në kuadër të kësaj kategori shpenzimet e trajnimit kanë qenë shpenzimet kryesore dhe më të mëdha të AD.

AD ende vazhdon veprimtarinë në objekt me qira dhe shpenzimet e qirasë janë ndër shpenzimet tjera më të mëdha për këtë periudhë, ndërsa shpenzimet tjera kryesisht janë në shuma më të vogla.

Shënimi 4 Shpenzime komunale

Përshkrimi	Gjithsej								Buxheti	Ndryshimi Buxheti -	2023	2022
	Pagesat € '000	FH € '000	KI € '000	FZHM € '000	GQ € '000	THV € '000	THD € '000	GPD € '000	Final € '000	Pagesat € '000	€ '000	€ '000
Rryma	8				8						7	5
Uji	0				0						0	0
Mbeturinat	1				1						0	1
Ngrohja Qendrore	-											
Shpenzimet telefonike	2				2						2	2
Pagesa-vendimet gjyqësore												
Pagesa -Neni 39.2 LMFPP	-											
Shpenzime komunale	11	-	-	-	11	-	-	-	11	0	9	8

Buxheti fillestar ka qenë 16,500.00 euro, ndërsa sipas vendimit të datës 18.12.2024 me numër 14/238 të Qeverisë së Republikës së Kosovës është reduktuar buxheti në këtë kategori për 5,500.00 euro, buxheti përfundimtar në këtë kategori është 11,000.00 euro.

Shënimi 5 Subvencione dhe transfere

AD nuk ka subvencione dhe transfere.

Shënimi 6 Shpenzime kapitale

Përshkrimi	Gjithsej								Buxheti	Ndryshimi Buxheti - Pagesat	2023	2022
	Pagesat € '000	FH € '000	KI € '000	FZHM € '000	GQ € '000	THV € '000	THD € '000	GPD € '000	Final € '000	€ '000	€ '000	€ '000
Ndërtesat e banimit	-											
Ndërtesat administrat.afariste	-											
Objektet arsimore	-											
Objektet shëndetësore	-											
Objektet kulturore	-											
Objektet sportive	-											
Objektet memoriale	-											
Rrethoja	-											
Depot	-											
Garazha	-											
Fushat sportive	-											
Ndërtimi i auto rrugëve	-											
Ndërtimi i rrugëve regjionale	-											
Ndërtimi i rrugëve lokale	-											
Trotualet	-											
Kanalizimi	-											
Ujësjiellësi	-											
Mirmbajtja investive	-											
Furn.me rrym.gjenrimitransmis	-											
Paisje të teknologjis inform	49				49						39	
Kompenzimi për inflacion*	-											
Softver	-										24	
Pajisje tjera	-										0	
Vetura Zyrtare	-										32	
Shpenzime Kapitale	49	-	-	-	49	-	-	-	50	1	96	-

Buxheti

fillestar dhe përfundimtar për shpenzime kapitale ka qenë në vlerë prej 50,000.00 euro, prej të cilave janë shpenzuar 48,548.51 euro, në kuadër të kësaj kategori janë blerë dy sete të pajisjeve të përkthimit dhe janë montuar në dy salla të AD-së.

Shënimi 7 Tjera

AD nuk ka fond nga huamarrjet.

Shënimi 8 Te hyrat tatimore

Shënimi 9 Të hyrat jo tatimore

Shënimi 10 Të hyrat e dedikuara

Shënimi 11 Grantet e përcaktuara të donatorëve

11.1 Donacioni e menaxhuara nga AD

			2024	2023	2022
			€ '000	€ '000	€ '000
Përshkrimi					
GIZ	Numri i projektit	Emri i projektit		-	-
UNDP	Numri i projektit	Emri i projektit	4	17	13
JUFREX	Numri i projektit	Emri i projektit		-	12
Gjithsej			4	17	25

Shpenzimet e prezantuara në kuadër të shënimit 11.1 janë shpenzimet e krijuara me rastin e implementimit të projektit me UNDP. Totali i donacioneve të realizuara për vitin 2024 ka qenë 4,043.60 euro, nga të 43.60 janë bartje nga viti i 2023.

11.2 Donacionet e menaxhuara nga vet donatorët:

Në tabelën 11.2 shpalosen donacionet e menaxhuara nga vet donatorët, që do të thotë se këto mjete nuk kanë rrjedhë përmes Llogarisë së Thesarit.

			2024
Emri donatorit			Euro
Fondacioni për të Drejtat e Kafshëve			1,922.61
Humanitarian Law Center Kosovo			2,504.08
IPROCEEDS - CYBERKOP			29,254.47
KE / Mbështetja e Gjykatës Kushtetuese në zbatimin dhe shpërndarjen e standardeve të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut			12,896.57
Këshilli i Evropës - PRO-FREX			15,300.00
KOMF			10,279.92
UNODC			50,577.35
OPDAT			68,730.81
EULEX			14,578.43
QKRMT			1,405.60
FMCS – INL dhe IKD			27,702.46
SCAC			3,500.00
Ambasada Franceze			1,330.00
WBROLI			115,000.00
GIZ			39,390.00
UNHCR			498.12
PECK III			8,849.90
CLARD			2,862.87
Terre des hommes Kosovo			2,520.00
Totali i Granteve në euro			409,103.19

Sipas informatave të ofruar nga përfaqësuesit e projekteve me donator në këtë tabelë bëhet shpalosja e mbështetjes financiare nga donatorët vetëm në totalin e shpenzimeve ashtu siç janë pranuar, pa pasur mundësi të shpalosen në detaje.

Prezantimi dhe shpalosja e donacioneve në këtë rast tregon qartë se AD edhe në këtë vit ka realizuar aktivitetet trajnuese në mbështetje të donatorëve të ndryshëm. Edhe pse nuk janë të specifikuara dhe të detajuara, shpenzimet e mbuluara kanë qenë kryesisht shpenzimet për shërbimet e trajnimit, shpenzimet e botimeve dhe publikimeve, shpenzimet për vizita studimore, vlera totale e këtyre shpenzimeve është 409,103.19 euro.

Shënimi 12 Tjera

Natyra e pranimi	2024 € '000	2023 € '000	2022 € '000
Depozitat 1			
Depozitat 2			
Depozitat 3			
Depozitat tjera			
Gjithsej	0	0	0

Shpalos në detaje shënimet në tabelë:

Shënimi 13 Pagesa nga palët e treta

	2024	2023	2022
Kategoria ekonomike	€ '000	€ '000	€ '000
Paga dhe shtesa			
Mallra dhe shërbime			
Shpenzime komunale			
Transfere dhe subvencione			
Shpenzime kapitale			
Gjithsej pagesat nga palët e treta	0	0	0

Shpalos tabelën në detaje si në tabelën në vijim aneks 1:

Neni 16 Raport për të arkëtueshmet

Të arkëtueshmet (zbatohet për organizatat që mbledhin të hyra)

AD nuk ka realizuar të hyra.

Neni 17 Raport për detyrimet (faturat) e papaguara

		2024		2023		2022	
Kategoria							
Ekonomike	Kategoria ekonomike	< 30 ditë	> 30 ditë	< 30 ditë	> 30 ditë	< 30 ditë	> 30 ditë
11	Paga dhe shtesa						
13	Mallra dhe shërbime	508.10		2,409.61		1,565.50	
14	Shpenzime komunale	1,103.16		28.63		654.74	
20	Transfere dhe subvencione						
30	Shpenzime kapitale						
Gjithsej		1,611.26	-	2,438.24	-	2,220.24	-

Neni 18 Detyrimet kontingjente

AD nuk ka shpenzime për këtë kategori.

Neni 19 Raport për pasurinë jo financiare

Neni 19.3.1 Pasuritë kapitale (me vlerë mbi 1000 Euro)

Klasifikimi i pasurive	2024	2023	2022
Ndërtesa			
Toka			
Pajisjet	10,089.91	6,416.70	13,917.61
Infrastruktura			
Makineria			
Automjetet	27,252.88	31,795.00	
Tjera	20,742.84	24,200.00	
Gjithsej	58,085.63	62,411.70	13,917.61

Pasurit jofinanciare kapitale të AD, janë të gjitha pasuritë kapitale të regjistruara në SIMFK. Në vlerën totale të pajisjeve veturave dhe të tjera përfshihet vlera neto.

Neni 19.3.2 Pasuritë jo kapitale (me vlerë nën 1,000 Euro)

Klasifikimi i pasurive	<u>2024</u>	<u>2023</u>	<u>2022</u>
Pajisjet dhe mobiljet	<u>72,151.69</u>	<u>45,756.03</u>	<u>26,721.25</u>
Gjithsej	<u>72,151.69</u>	<u>45,756.03</u>	<u>26,721.25</u>

Pasurit jo financiare jo kapitale të AD janë të gjitha pasuritë jo kapitale të regjistruara në E-pasuri. Në vlerën totale të pajisjeve përfshihet vlera e pajisjeve që disponon AD me 31 dhjetor 2024.

Neni 19.3.3 Stoqet

Klasifikimi i pasurive	<u>2024</u>	<u>2023</u>	<u>2022</u>
Stoqet	<u>13,008.85</u>	<u>14,759.69</u>	<u>13,126.89</u>
Gjithsej	<u>13,008.85</u>	<u>14,759.69</u>	<u>13,126.89</u>

Vlera e stokut në fund të vitit 2024 është në vlerë prej 13,008.85 euro, ku këtu përfshihen materialet që janë të nevojshme për mbarëvajtjen e punës në AD.

Neni 20 Raport për avancet e pa arsyetuara

AD nuk ka avance të bartura nga vitet e kaluara, dhe nuk ka avance të parsyertuara.

Neni 21 Raport për të hyrat vetanake të pashpenzuara

AD nuk realizon të hyra vetanake.

Neni 22 Raport për bilancet e pashpenzuara të Fondit Zhvillimor në Mirëbesim

AD nuk ka shpenzime për këtë kategori.

Neni 23 Raport për të hyrat e dedikuara

AD nuk ka të hyra të dedikuara.

Neni 24 Raport për fondet e donatorëve të pashpenzuara

Përshkrimi	2024	2023	2022
Grantet e përcaktuara të donatorëve të bartura nga viti i kaluar	43.60	2,400	4,227.11
Grantet e përcaktuara të donatorëve të pranuar në këtë vit	4,000.00	14,728	22,780.00
Totali në dispozicion për ndarje në vitin aktual	4,043.60	17,128.00	27,007.11
Shuma e shpenzuar në vitin aktual	4,043.60	17,084	24,607.11
Bilanci për bartje	-	43.60	2,400.00

Totali i donacioneve të realizuara për vitin 2024 ka qenë 4,043.60 euro, nga të cilat 43.60 euro janë bartje nga viti i 2023, ndërsa janë shpenzuar 4,043.60 euro apo total donacionet.

Neni 25 Raport për numrin e punëtorëve sipas listës së pagave

Departamenti	Nr i punëtorëve në Ligjin e buxhetit	Nr aktual i punëtorëve në fund të 2024		Nr aktual i punëtorëve në fund të 2023		Nr aktual i punëtorëve në fund të 2022	
		Me orar të plotë	Me orar të shkurtuar	Me orar të plotë	Me orar të shkurtuar	Me orar të plotë	Me orar të shkurtuar
Zyra e Drejtorit	5	4		2		2	
Departamenti i Programeve Trajnuese	13	12					
Departamenti për shërbime ligjore dhe të Përgjithshme	11	10		13		13	
Divizioni për Buxhet dhe Financa	3	3		10		10	
Gjithsej	32	29	0	25	0	25	

Numri i aprovuar i stafit me buxhetin e vitit 2024, ka qenë 32 pozita, ndërsa të plotësuarja janë 29 pozita.

Neni 26 Raport për numrin e të punësuarve jashtë listës së pagave

Departamenti	Nr aktual i punëtorëve në fund të 2024		Nr aktual i punëtorëve në fund të 2023		Nr aktual i punëtorëve në fund të 2022	
	Me orar të plotë	Me orar të shkurtuar	Me orar të plotë	Me orar të shkurtuar	Me orar të plotë	Me orar të shkurtuar
Departamenti 1						
Departamenti 2						
Departamenti 3						
Gjithsej						

Sqarim: Shpalos arsyen e angazhimit, kohëzgjatjen, qëllimin dhe listën e personave të angazhuar.

Neni 27 Raport për numrin e të punësuarve me kontrate për shërbime të veçanta

Departamenti	Nr aktual i punëtorëve në fund të 2024		Nr aktual i punëtorëve në fund të 2023		Nr aktual i punëtorëve në fund të 2022	
	Me orar të plotë	Me orar të shkurtuar	Me orar të plotë	Me orar të shkurtuar	Me orar të plotë	Me orar të shkurtuar
Departamenti 1						
Departamenti 2						
Departamenti 3						
Gjithsej						

Sqarim: Shpalos arsyen e angazhimit, kohëzgjatjen, qëllimin dhe listën e personave të angazhuar

Neni 28 Raport për gjendjen/zbatimin e rekomandimeve të Zyrës Kombëtare të Auditimit (ZKA)

Nr	Gjetja	Veprimi i ndërmarrë	Afati i zbatimit	Statusi aktual i rekomandimit	Vleresimi i rrezikut
1	Çështja B1 - Funksionimi i pozitave të larta udhëheqëse me ushtrues detyre	Për te gjitha pozitat qe kanë qenë të lira, kanë filluar proceset e rekrutimit në fillim te vitit 2024 dhe një pjese e pozitave qe kanë qenë te lira janë plotësuar.		Realizuar	
2	Çështja A1 - Zotimi i mjeteve dhe nxjerrja e urdhër blerjes pas pranimi të faturës	Zotimi i mjeteve dhe nxjerrja e urdhërblerjeve do të kryhen para pranimi të faturave.	Qershor - Dhjetor 2024	Realizuar	

Gjetja B1, të gjitha pozitat që kanë qenë të mbuluara me ushtrues detyre janë plotësuar me staf të rregullit.

Gjetja A1, Pas pranimi të draft raportit të auditimit ka filluar të behet zotimi i mjeteve dhe nxjerrja e urdhërblerjeve para pranimi të faturave.

Aneksi Nr. _ Kompensimi sipas ligjit për mbështetjen e punëve publike

Kodi i ekonomik	Kodi i Projektit	Përshkrimi i projektit	2024
Kodi ekonomik	Numri i projektit	Emri i projektit	-
Kodi ekonomik	Numri i projektit	Emri i projektit	-
Kodi ekonomik	Numri i projektit	Emri i projektit	-
Gjithsej			0